



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE
KOMUNIKIMIT**

TEMA E MAGJISTRATURËS

**INTERTEKSTUALITETI NË ROMANIN
"KUSH E SOLLI DORUNTINËN", TË ISMAIL KADARESË**

Punoi

Islam Haxhiu

Mentor:

Doc. dr. Meral Veseli-Shehabi

Qershor, 2021

MIRËNJOHJE DHE DEDIKIM

Nuk po i gjejë fjalët që dua (i varfër jam nga ato) për të shprehur gjithë **mirënjohjen** time të thellë për profesorët e nderuar nga Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit, pranë Universitetit të Evropës Juglindore, e sidomos: Prof. dr. Zeqir Kadriu, Doc.dr. Luljeta Adili Çeliku, Prof.dr.Hamit Xhaferi, Prof.dr. Ismet Osmani dhe Doc.dr. Meral Veseli-Shehabi, që me idetë e tyre të vyera, me përkushtim dhe kopetencë të një eksperience profesionale, më udhëhoqën gjatë këtij cikli studimesh të cilat u kurorëzuan me këtë punim magjistrature.

Veçanërisht, dua të falënderoj nga zemra profesoreshën dhe mentoren time, Doc.dr. **Meral Veseli-Shehabi**, për angazhimin, përzemërsinë dhe punën e saj të pakursyer gjatë punimit dhe formësimit të kësaj teme të përzgjedhur bashkërisht. Sepse, pa ndërhyrjet dhe këshillat e saj profesionale të përshkuara nga një devotshmëri e lartë njerëzore, sigurisht që ky punim nuk do të ishte, strukturuar, gdhendur dhe përmbyllur në këtë formë.

Poashtu, një falënderim të madh dua të ndaj për mikun dhe kolegun tim, Arbër Malota, një njeri dhe student i shkelqyeshëm, me të cilin bashkudhëtuam përgjatë këtyre viteve të ngritjes sonë akademike. Dua të them se ky rrugëtim yni nuk do të ishte veshur me këto ngjyime suksesi pa çiltërsinë dhe përkrahjen e rezervë të profesorëve tanë të nderuar të lartëpërmendur, që besuan në njohuritë tona modeste për gjuhën dhe letërsinë.

Pa familje të shëndoshë, nuk ka as shoqëri e as komb të shëndoshë. Dua të them, se, me fjalë nuk mund ta përshkruaj dot falënderimin dhe mirënjohjen e thellë që kam për familjen time: Teutën, Teisën, Ilirianin, Atlantidën, Endrisin dhe nënën time të dashur, e që **ua dedikoj** këtë punim të magjistraturës, *specifikisht; bukurshkruesit fjalë – ambël dhe adhuruesit të arsimimit të kombit, prindit tim Hysenit, që prej tre vitesh pushon në qetësi.*

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	Error! Bookmark not defined.
Abstract:.....	Error! Bookmark not defined.
Апстракт	Error! Bookmark not defined.
LËNDA E HULUMTIMIT	Error! Bookmark not defined.
METODOLOGJIA E PUNIMIT	Error! Bookmark not defined.
QËLLIMI I PUNIMIT	Error! Bookmark not defined.
HIPOTEZAT.....	Error! Bookmark not defined.4
HYRJE	Error! Bookmark not defined.5
KREU I	Error! Bookmark not defined.8
1.1. Jeta dhe vepra e Ismail Kadaresë	Error! Bookmark not defined.8
1.2. Vlerësime për Kadarenë.....	22
KREU II	Error! Bookmark not defined.
2.1. Intertekstualiteti	Error! Bookmark not defined.
2.1.1. Ç’është intertekstualiteti	Error! Bookmark not defined.4
2.2. Intertekstualiteti si dinamike tekstuale	26
2.3. Intertekstualiteti si sistem marrëdhëniesh.....	27
2.4. Interteksti si formë terrorizmi i referencës (terrori në letër të bardhë).....	28
2.5. Tipologjia e intertekstualitetit.....	28
2.5.1. Marrëdhënia e bashkëpranisë.....	28
2.5.2.Citati si inertekestt.....	28
2.5.3. Metateksti.....	29
2.5.4. Referenca si intertekstualitet.....	29
2.5.5. Vjedhja	30
2.5.6. Aluzioni.....	30
KREU III	Error! Bookmark not defined.2
3.1. Balada si krijim epiko-lirik	Error! Bookmark not defined.2
3.2. Balada e ringjalljes.....	Error! Bookmark not defined.4
3.3. Kulti i besës(fjalës së dhënë).....	39
KREU IV	Error! Bookmark not defined.1

4.1. Miti dhe rikthimi i tij te Kadareja.....	41
4.1.1. Çka është miti.....	41
4.1.2. Studimi i mitit.....	42
4.2. Mitit në letërsi shqipe	42
4.3. Miti i ringjalljes dhe miti religjioz	44
4.4. Rimarrja e mitit (si intertekst) nga Kadareja.....	46
4.5.Miti te romani Kush e solli Doruntinën	48
KREU V.....	51
5.1. Intertekstualiteti në romanin Kush e solli Doruntinën dhe miti si intertekst.....	51
5.2. Intertekstualiteti dhe legjenda e pasqyruar në formë letare.....	65
KREU VI	Error! Bookmark not defined.8
6.1. Personazhe në vepër - Kategorizimi i tyre	Error! Bookmark not defined.8
6.2. Gjetje krahasimesh në mes të baladës dhe romanit.....	Error! Bookmark not defined.9
PËRFUNDIMI	Error! Bookmark not defined.1
BIBLIOGRAFIA	Error! Bookmark not defined.3

ABSTRAKT

Studimi mbi intertekstualitetin në romanin *Kush e solli Doruntinën* të autorit Ismail Kadare, krahas të gjitha fushave tjera studimore albanologjike, përbën një organizim shumë interesant, mjaft tërheqës, por aspak të lehtë për trajtim thelbësor. Përkundrazi, studimi është një detyrë e vështirë shkencore e cila kërkon analizë të thukët mbi kulturën, mendësinë shoqërore dhe rrjedhën e saj, sidomos në hapësirën ballkanike dhe evropiane. I vetëdijshëm për këtë detyrë të vështirë, ne do të përiqemi që gjatë lëndës së trajtimit të kësaj teme, në këtë rast intertekstit në romanin e Ismail Kadaresë, “Kush e solli Doruntinën”, të jetë një prurje e re, një prirje ndryshe nga një lexim i zakonshëm, duke e analizuar thellë në intertekstin e saj përbrenda tekstit të romanit tonë me të gjitha përmasat do të thoshim universale, që sjellë para nesh një ambasador i letrave shqipe, siç është Ismail Kadare.

Romani *Kush e solli Doruntinën* parasegjithash është një krijim i natyrshëm kadarean, një kryevepër e ndërtuar me qartësi të jashtëzakonshme mendimi brenda - përbrenda dimensionit të saj, e cila trajton forcën e kodit moral të *besës*, në njërin anë, dhe kodin natyral në mes *jetës dhe vdekjes*, në anën tjetër. Në epos shfaqet në formën e vdekjes së përkohshme ndërsa në fondin e baladave paraqitet një formë tjetër e ringjalljes, ajo e frymës humaniste. Punimi dhe shtjellimi i kujdeshëm i kësaj teme kemi bindjen se do të na mundësoj njohjen më të mirë të mitit dhe funksionit të tij, të cilit Kadare i jep gjatë interpretimit intertekstual. Në këtë mënyrë bëhet dallimi midis konceptit si interpretim, nga njëra anë, dhe koncepteve; ndikim e intertekstualitet, në anën tjetër. Personazhet kryesore të romanit janë *Doruntina* dhe *Stresi*, ndërsa *Zonja Mëmë* dhe *Kostandini* janë pika lidhëse që peshojnë gjithë tragjedinë dhe misterin e veprës. Ajo çka përbën rëndësi të veçantë për analizën tonë është lidhja e Doruntinës me të vëllain dhe me Stresin. Marrëdhënia e saj me Kostandinin është një lidhje gjaku që kapërcen çdo kufi imagjinar...

Fjalët çelës: teksti, ringjallja, Konstandini, mit, Kadare, intertekstualitet, kod, besë, inçest etj

Abstract:

The study on intertextuality in the novel "Who brought Doruntina" by Ismail Kadare, in addition of all other fields of albanological study, another easy intervention to address the essential, but rather a color analysis on culture, kindness and the flow of life , especially in the Balkans and Europe. Aware of this, during of this topic, in this case the intertext in Ismail Kadare's novel, "Who brought Doruntina", I'll try to bring a different behavior for another, a different tendency from a reading simple and deeply analyzed in its intertext for the text of our novel with all the dimensions and layers full of variety that an ambassador of Albanian letters, such as Ismail Kadare, bring to us. The novel "Who brought Doruntina" is an original creation that deals with the strength of the moral code of faith and the natural code between life and death. Resurrection is one of the very, very old motifs with pre-biblical and biblical character in the Albanian epic and the fund of ballads. In the epic it appears in the form of temporary death while in the fund of ballads another form of resurrection is presented, that is the humanist spirit. Through this careful elaboration and elaboration of this topic, I am convinced will enable me to better understand the myth and its function, which Kadare gives during the intertextual interpretation. In this way a distinction is made between the concept as interpretation, on the one hand, and the concepts; influence of intertextuality, on the other hand. Especially the differences between Kadare's myth and the text, the questions and answers raised by the text, the importance of the myth then formulated as a text (novel, novel), etc. The main characters of the novel are Doruntina and Stress, while the mother and Constantine are the connecting point that raises the tragedy and mystery of the whole work. Of particular importance to our analysis is Doruntina's relationship with her brother and Stress.

Keywords: text, resurrection, Constantine, myth, Kadare, intertextuality, code, faith, incest, etc.

ИНТЕРТЕКСТУАЛНОСТА ВО РОМАНОТ *KUSH E SOLLI DORUNTINËN* НА ИСМАИЛ КАДАРЕ

Студиите за интертекстуалноста во романот “Kush e solli Doruntinën” на Исмаил Кадаре, во компарација со сите други насоки на албаноолошките студии, претставува преземање за основно третирање, но напротив една детална анализа за културата, свеста и текот на животот, особено во Балканскиот и Европскиот простор. Свесен за ова, јас ќе се потрудам при анализа на предметот на ова тема, за интертекстуалноста во романот на Исмаил Кадаре “Kush e solli Doruntinën”, да носиме нови протоци, еден различен тренд од еден обично читање и анализирање, со помош на нејзиниот интертекст во внатрешноста на текстот на романот со сите димензии и многубините слоеви кои ни ги носи книжевниот амбасадор на албанците, Исмаил Кадаре.

Романот “Kush e solli Doruntinën” е оригинално дело која го третира моралниот код на дадениот збор и природниот код меѓу животот и смрта. Скраснувањето е еден од стасите мотиви со пред библиски карактер и библиски во албанскиот епос и во фондот на баладите. Во епосот се претставува во форма на привремена смрт додека во фондот на баладите се претставува една друга форма на инкарнација, таа на хуманитариот дух. Со анализа на ова дело имам престава дека ќе се овозможува на подобро познавање на митот и неговата функција, на која Кадаре му дава на интертекстуалната интерпретација. На овој начин се прави разлика меѓу концептот на интерпретација, од една страна, и концептите: влијанието на интертекстуалноста во другата страна.

Особено разликата помеѓу митот и текстот на Кадаре, прашањата и одговорите што ги отвара текстот, и важноста на митот формулиран како текст (новела, роман) и др. Главните ликови на романот се Дорунтина и Стрес, додека мајка му на Константин е врзаната точки која ги оживува трагедијата и мистерот на целото дело. Тао што е особено важно за нашата анализа е врската на Дорунтина со братот и Стрес. Нејзиниот однос со Констадин е крвна врска која преминува секо имагинарна граница.

Клучни зборови: текст, инкарнација, Костадин, мит, Кадаре, Интертекстуалност,
Код, даден збор, инцест идр.

LËNDA E HULUMTIMIT

Krahas trajtimit të vazhdueshëm të elementëve përbërës të romanit, *Kush e solli Doruntinën*, e që janë; *personazhet, motivi i besës, elementi i mitit*, qoftë ai real apo imagjinar, ringjallja e kështu me radhë, ne do të trajtojmë me kujdes intertekstualitetin si lëndë kryesore e hulumtimit, midis konceptit si interpretim, në një rën anë, dhe koncepteve mbështetje e intertekst, në anën tjetër. *Në mënyrë të veçantë ndryshimet që shpërfaqën në mes mitit dhe tekstit autorial të Kadaresë, pyetjet, dilemat dhe përgjigjet që shkëput teksti, e veçanta e mitit e formuluar pastaj në formën e tekstit etj.* (Isufaj, Miti te Kadareja, 2013) Puna jonë studimore, pra, do të përqendrohet në njohjen më të mirë të personazheve në roman e sidomos në motivin e ardhjes së Doruntinës dhe atë të ringjalljes së vëllaut, Kostandinit.

Një formë e re e interpretimit intertekstual, e ndërtimit të tekstit të ri në mënyrë pothuajse të përkryer nga Kadare, mbase e rritë nivelin artistik jo vetëm të veprës porse e vërteton faktin se një pjesë e letërsisë është interpretim i një kodi tjetër, në rastin tonë, i një kodi letrar dhe mitik. Nuk mund të ketë tekst të ndërtuar pa ndonjë personazh thonë studiuesit, ashtu siç nuk mund të gjendet një tekst unik dhe i pabazuar në një tekst tjetër pararendës. Ai mbetet i pazëvendësueshëm edhe atëherë kur autori i tekstit flet me gjuhën e tij gjatë ndërtimit të një narracioni të ri.

Njëjtë siç Kadare vepron në romanin *Kush e solli Doruntinën*, kur vendos t'i rikthehet mitit përmes këtij narracioni të jashtëzakonshëm duke ngritur në lartësinë e letërsisë një kryevepër si kjo e trajtimit tonë, *Kush e solli Doruntinën*. Prandaj siç edhe e kemi cekur më lartë, këtë roman, do ta studiojmë duke i shqyrtuar dhe analizuar në mënyrë të veçantë të gjitha elementet e tij, siç janë: *legjenda apo balada mbi të cilën ndërtohet romani, motivet si mbajtësi kryesor i veprës, pastaj studimi i miteve, kulti i fjalës së dhënë - besës*, gjithnjë në funksion të ringjalljes së Kostandinit dhe porosisë së përjetshme të mitit në traditën shqiptare. Pastaj të përbashkëtat e motivit të besës tek autori me ato të baladës së ringjalljes, e poashtu edhe dallimet dhe ngjajshmëritë në mes baladës së ringjalljes nga letërsia gojore arbëreshe dhe romanit, *Kush e solli Doruntinën*. Pastaj, ndërthurjes së subjektit dhe ndërtimit narrativ në përpjekje për t'i dhënë përgjigje misterit të përhershëm të sjelljes së Doruntinës tek e ëma, etj.

Dhe, në të gjitha këto elemente do të trajtohet edhe pjesa qendrore e punimit tonë, përpjekja për të paraqitur dhe analizuar me vëmendje, në mënyrë sa më qartë *tekstin letrar si interpretim i një teksti tjetër*, që tashmë e quajmë **intertekstualitet**.

Legjenda e Konstandinit dhe Doruntinës pa asnjë dyshim është një nga perlat e folklorit shqiptar dhe shprehje e gjenialitetit të krijimit popullor shqiptar. (www.portalishkollor.al, n.d.) E ndërtuar me mjeshtri të rrallë në frymën e traditës dhe kujtesën folklorike shqiptare, atë e gjejmë në disa mënyra. Kjo e vërtetë është shkruar edhe nga Francesco Altimari në parathënien e romanit të ribotuar Kush e solli Doruntinën: *Në traditën folklorike shqiptare hasim shumë variante të tjera të baladës, e cila në rrjedhë të shekujve ka pësuar ndryshime të thella, që pasqyrojnë në njëfarë mënyre ndryshimet fetare dhe kulturore të vetë shoqërisë shqiptare. Ja sepse ajo na paraqitet e larmishme edhe nga pikëpamja e karakterizimit antroponimik të personazheve kryesore - ortodokse ose myslimane – sipas besimit fetar që nbizotëron në treva të ndryshme të vendit. Kështu, Kostandini bëhet Halil Garrija ose Ali dhe Doruntina bëhet Fata në mjedisn mysliman, ndërsa Dhoqina, në mjedisin ortodoks.* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 12). E ndërsa, Jacob Grimm shkruante në kohën e tij, se; *”kjo legjendë është një nga këngët më tronditëse të popujve në të gjitha kohërat”* (<http://www.letersia.fajtori.com>, n.d.). Se është një nga krijimet (legjendat) më të vjetra shqiptare vërtetohet edhe me faktin kur në vitin 1875 konsulli francez, posa e kishte dëgjuar e botoi në përmbledhjen e tij “Contes albanaises” (Tregime të moçme shqiptare (www.portalishkollor.al). *“Rilindasi Thimi Mitko e gjeti këtë legjendë tek arbëreshët e vendosur nën titullin “Udhëtimi i Konstandinit të vdekur” , ndërkohë që Dhimitër Kamadra e botoi me titullin “Konstandini dhe Doruntina”. Kësaj legjende të vjetër mesjetare shqiptare, një jehonë të veçantë i bëri edhe Dora d’Istria në esenë e saj, “Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore” të botuar në Francë në vitin 1866”* (www.portalishkollor.al). Të rrallë janë ata letrarë e artistë që nuk janë frymëzuar nga kjo legjendë; për pjesët teatrale, tekstet dhe kompozimet muzikore, veprat në artin figurativ dhe për romanet e tyre, siç e kemi rastin e ndërtimit mjeshhtëror të romanit kryevepër të Ismail Kadaresë ,”Kush e solli Doruntinën”. Ndaj, edhe ne si lexues besnik, jo vetëm të veprave të Kadaresë, gjithmonë frymëzohemi nga kjo krijimtari letrare në radhë të parë, por gjithësesi edhe nga krijimtaria e pasur dhe e bollshme gojore, për njërën ndër legjendat e vjetra shqiptare me gjasë që nga mesjeta, “Kush e solli Doruntinën”. Vepër e cila kësaj radhe do të jetë objekt i trajtimit në këtë punim magjistrature.

Në veprat e tij madhështore, e sidomos në novelën “Kush e solli Doruntinën”, Ismail Kadare ka huazuar tema nga historia e folklorit shqiptar dhe jo vetëm, nga tregimet, baladat dhe mitet, në mënyrë që me mprehtësinë e mendimit të krijoj botën e tij narrative. *“Bota e Ismail Kadaresë është një lloj anti-materie. Ajo mund ta shkatërrojë tonën. Vetëm se ndryshe nga ç’ndodh me grimcat elementare në fizikë, bota e tij plotëson tonën duke lënë gjurmë të jashtëzakonshme”* (Jeta e re, 2011, f. 6).

“Kjo legjendë mesjetare, e njohur botërisht, është pikërisht novela e udhëtimit të Doruntinës me vëllanë e vdekur!? Dhe pikërisht, kjo është enigma e cila kurdoherë të zgjon kureshtje të vazhdueshme, dhe e cila u bë shkas për përzgjedhjen e kësaj teme ku është rindërtuar miti nga një mendje e zgjuar, siç është ajo e Kadaresë”. (www.kultplus.com, n.d.).

Përdorimi i mitit në krijimin e teksteve të reja merret dhe rikrijohet për një arsye të veçantë, apo thjeshtë nga dëshira për të eksperimentuar e për të sjellë diçka të re, në këtë rast përmes rikthimit të mitit. Sepse, parasegjithash; “zhdukja, ringjallja, madje lindja e miteve janë elemente të rëndësishme të kërkimit të tipit antropologjik”. (Chevrel & Chevrel, 2002, f. 80)

METODOLOGJIA E PUNIMIT

Gjatë punimit të kësaj teme të magjistraturës, përkatësisht këtij studimi, do të përdorim këto metoda shkencore;

1. **Metodën teorike**, në kuadër të së cilës do të shqyrtohet dhe analizohet *teoria e intertekstit* e sidomos *teoria në raport me mitin*;
2. **Metodën komparative** apo (krahasuese) - përmes së cilës do të krahasohet romani, *Kush e solli Doruntinën*, në shumë rrafshje, duke përfshirë këtu elementet të cilat janë pjesë e pandarë e gjithë veprës, si motivi i besës, mitit, ringjalljes etj. Duke u ndalur veçmas tek citati, metataksti, qasja strukturaliste etj.
3. **Metodën deskriptive** - me anë të së cilës do të shprehim përshkrimet dhe analizimin e roleve të personazheve të veprës, personazhe këto që përmes narracionit të përkryer kadarian na paraqiten poashtu të përkryera në rolin e tyre, e të cilat natyrshëm e formojnë trekëndëshin ideal edhe në kuptimin intertekstual, siç janë: *Stresi*, *Doruntina Kostadini*;
4. **Metodën analitike** - përmes së cilës do të bëhet analiza e romanit sipas stilit të shkruar, gjuhës së ndërtuar dhe diskursit që përdoret në veprën letrare të Ismail Kadaresë, “*Kush e solli Doruntinën*”.

Realisht, një pjesë e konsiderueshme e këtij punimi do të jetë teorik, për vet faktin se do të mbështetemi në literaturën e nevojshme dhe të (deomosdoshme) me përbërje nga materiale te ndryshme të kësaj natyre, ndërsa pjesa tjetër do të mbështetet në metodën krahasuese duke bërë krahasimin midis veprave të ndryshme të këtij autorit dhe jo vetëm. Edhe metoda e hulumtimit do të bëhet duke shfletuar material nga interneti, gjë që shpresojmë të na mundësojë studim dukshëm më të lehtë në metodologjinë dhe punën tonë.

Sepse, paraprakisht jemi të bindur se pa një zgjerim të tillë kërkimor rreth kësaj teme, nuk mund të sjellim të plotë idenë rreth përfundimit me sukses të këtij punimi. Sepse, Ismail Kadare me sjelljen e kësaj vepre në botën shqiptare ku vazhdimisht përplasen e kaluara dhe e sotmja, jo vetëm që solli freskinë e mitit shqiptar përmes *Doruntinës*, porse hapi mundësi të mëdha për interpretim dhe studim të mitit në njëren anë, por në anën tjetër solli edhe një arritje të re interpretimi në botën e letërsisë.

Prandaj vlerësojmë se si metodë studimi për të realizuar këtë punim na nevojitet *metoda biografike* e autorit, pasi kemi një sërë faktorësh që kanë ndikur në formimin dhe zhvillimin e këtij personaliteti të letrave shqipe.

Pastaj, *metodën sociologjike*, e cila na ndihmon gjithashtu për të studiuar më mirë e më saktë disa faktorë tjerë, që ndikojnë dukshëm në botëkuptimin e një shkrimtari siç janë: *faktorët historikë, kulturorë dhe politikë*. E në anën tjetër, poashtu një rëndësi të veçantë në këtë punim e ka edhe; *metoda e krahasimit* për të nxjerrë të përbashkëtat e veprës “*Kush e sollli Doruntinën*” në raport me baladat e vjetra të ngjajshme të krijimit, përkatësisht rindërtimin e miteve nëpër kohë, e rrjedhimisht edhe intertekstualitetin brenda tyre, e që në fakt paraqesin brumin e letërsisë shqiptare e të cilat nuk kanë reshtur asnjëherë së provokuari sedrën tonë në kuptimin emocional, e sidomos në trajtimin e temave studimore para nesh.

Ndërsa gërshetimi i kujdesshëm i këtyre metodave, në fakt përbën atë që ne e quajmë *metodologji kërkimi*.

QËLLIMI I PUNIMIT

Me anë të këtij punimi, përveç tjerash, qëllim kryesor kemi nxjerrjen në pah të të shkuarës mitologjike dhe historike të shqiptarëve, te vepra “Kush e solli Doruntinën”. Edhe sipas Kadaresw kjo baladë është ndër më të vjetrat, dhe pikërisht në mjedisin arbëresh ruan një nga variantet më të bukura, më origjinale dhe më të lashta, shprehje edhe e vendit qendror që zë koncepti i besës në identitetin dhe kujtesën kolektive të arbëreshëve të Italisë. Apo siç thotë Francesco Altimari në parathënien e romanit Kush e solli Doruntinën të ribotuar nga Shtëpia Botuese Onufri: *“Kadare e merr shkasin nga version tradicional arbëresh i baladës, mirëpo romani vetëm pjesërisht e ndjek rrjedhën e rapsodisë arbëreshe. Në fakt skema narrative e Kadaresë del si rezultat i përzierjes dhe kontaminimit të traditave të ndryshme rajonale dhe fetare, siç dëshmohen në baladën shqiptare që gjithësesi anon nga versioni ortodoks i përhapur në Shqipërinë e Jugut, me ndonjë ndikim ndërjetar”*. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 12).

Qëllimi i punimit përfshin parasegjithash intertekstin, i cili nënkupton ndërtimin e një teksti të ri brenda një teksti tjetër, shndërrimin e miteve etno - religjioze në mite letrare – në rimarrjet e domosdoshme gjatë ndërtimit të narracionit në rastin tonë në veprën e Kadaresë, e të cilat janë të vendosura sipas një rregulli të caktuar duke ndërtuar lidhje të rëndësishme dhe maradhënie të caktuara estetike, e të cilat poashtu formojnë një sistem të veçantë komunikimi.” (Isufaj, Miti te Kadareja, 2013). Pastaj duke i përfaruar me to, gjetjet dhe krahasimet eventuale me variantet e tjera të tregimit të baladës, të cilat e pasuruan lëndën e punimit tonë gjatë trajtimit të kësaj teme. Prandaj në këtë kuptim veçsa është pasuruar lënda jonë kërkimore. *Sidomos zbrastësia e hasur në studimet e krahasuara në kontekstin shqiptar është një tjetër dimension i cili qëllimit tonë për gjetjet intertekstuale gjatë mbledhjes së tyre për të pasur në fund një pasqyrë më reale në romanin Kush e solli Doruntinën, i jep dimension të ri duke e bërë gjithnjë e më interesant.* (Isufaj , Miti te Kadareja, 2013). Më saktë, qëllimet e hulumtimi i kemi të ndara për ta parë relievimin dhe konfigurimin komentues të autorit, veprës, personazhit dhe rrëfimitarit, si edhe për të parë elementet mitike, mitin e besës, elementet baladeske dhe legjendën e njohur arbëreshe.

HIPOTEZAT

Gjatë studimit tonë dhe shqyrtimit të vëmendshëm të kësaj teme do të hulumtohen dhe trajtohet besnikërisht rëndësia dhe vlera e përgjithshme e miteve siç janë: miti i besës dhe miti i ringjalljes, nga romani tashmë i përzgjedhur, *Kush e solli Doruntinën*, bashkë me temën për studim”

Gjithashtu do të hulumtohet dhe thirrja e guximshme e romanit në drejtim të intertekstit mitik, personazheve mitike të veprës, miti shqiptar dhe miti i huaj, ngjajshmëritë dhe dallimet në mes tyre qoftë edhe si mënyra të reja të studimit të romanit për t’i njohur sa më mirë dhe sa më thellë personazhet e veprës sonë, paraqitja e tipareve thelbësore të përbashkëta përmes, krahasimi i tyre dhe renditja mbi bazën e vlerave stilistike dhe letrare gjithnjë në funksion të gjetjeve të reja intertekstuale.

Hipoteza e parë : motivi i ringjalljes në mënyrë shumë specifike do të hulumtohet personazhi i udhëtarit të vdekur, Kostandin i cili ringjallet dhe ngrihet nga varri

Hipoteza e dytë: motivi i kthimit të Doruntinës hulumtimi dhe vendosja e personazheve mitike në vepër dhe kërkimi i sjellësit enigmatik të Doruntinës

Hipoteza e tretë: zbërthimi i intertekstit, i cili paraqitet si larmi tekstesh në rastin tonë me tekstin e mitit shqiptar dhe atij të huaj. Pra mardhëniet intertekstuale, hulumtimi dhe krahasimi i mitit në relacion me personazhin e Kadaresë

Hipoteza e katërt: Kodet morale shqiptare dhe besa si shtyllë që e peshon krejt veprën *Kush e solli Doruntinën*.

Mëdyshjet e mëdha dhe pyetjet e vazhdueshme se kush e solli Doruntinën hapin disa fusha hetimi duke ngritur dyshime në lartësinë e enigmës apo misterit, në mënyra të papritura dhe befasuese, që nxjerrin poashtu hipoteza dhe përfundime të ndryshme.

Sidoqoftë intertekstualiteti dhe letërsia kanë marrëdhënie ndërvepruese të përbashkëta, prandaj mendojmë se tekstet e krijuara në kuptimin e traditave të caktuara letrare, e sidomos tekstet që janë pjesë e shqyrtimit tonë tematik, do të studiohen më saktë përmes hipotezave të parashtruara e mbi të cilat zhvillohet ky studim. Në këtë mënyrë studimi do të jetë më përmbajtësor sepse trajtohet me elemente shkencore të pranueshme dhe si i tillë mbase mund të sjellë një risi në fushën e letërsisë.

HYRJE

Në fund të viteve të 70-ta e në fillim të 80-tave, ende pa e lexuar romanin *Kush e solli Doruntinën* të autorit Ismail Kadare, atëherë si nxënës i shkollës fillore, pata rastin që krahas shumë filmave shqiptarë që atëbotë shfaqeshin në ekranin e TVSH- së, të përcjellë në ekran edhe dramën, *Kush e solli Doruntinën*, prodhim i Kinematografisë shqiptare. Shfaqje kjo, e realizuar artistikisht me një mjeshtri të lartë dhe e ndërtuar duke u bazuar në romanin (novelën) me po të njëjtin titull të autorit Ismail Kadare... (Po kujt mund t'i ketë shkuar mendja atëherë, që kjo vepër e ndërtuar mbi një legjendë, ky intertekst i parë, i autorit të madh shqiptar, Ismail Kadare, një ditë do të jetë temë bosht e një studimi modest që do të bëhej nga ana ime). Natyrisht që, ky përjetim në një moshë relativisht të re, nxiti kureshtjen time për të mësuar më shumë rreth kësaj drame njerëzore që në përmbajtje i kushtohej popullit tim shqiptar, mbi traditën folklorike në radhë të parë por edhe për fatin e rëndë që në të shumtën e përcolli historikisht.

Kjo nxitje, pra, u bë shkas që unë ne kërkojmë njohuri të reja mbi legjendën e vjetër për të cilën më vonë mësova se ishte e ndërtuar edhe në traditat e popujve tjerë të Ballkanit por edhe më gjërë. Nga mësuesi im i parë i Gjuhës dhe letërsisë shqipe, Mujë Ademaj, e nga poashtu nga prindi im Hyseni, ndjesë paçin, përveç se mësuam më shumë rreth kësaj legjende mijërvjeçare pata rastin të marrë dhe ta lexoi librin *Kush e solli Doruntinën* me autor Ismail Kadare. Dhe, prej atij momenti interesimi im për të mësuar më shumë rreth këtij tregimi jashtëzakonisht tërheqës, nuk është ndalur asnjëherë. Sepse tashmë para vetes kisha pasqyrimin e një bote shqiptare bashkë me tregimet e moçme, baladat dhe legjendat brenda të cilave hasim; motivet dhe mitet të ndërtuara përmes narracioneve të ndryshme, duke filluar nga tradita gojore e interpretimit. Sidomos për **besën** si fjalë a premtim i dhënë, për vlerën e veçantë që mban, për semantikën dhe rëndësinë e saj. Sepse edhe ashtu pothuajse e gjithë krijimtaria në prozë e Kadaresë është e përqëndruar kryesisht mbi dramën, tragjeditë dhe luftërat e pandërprera për mbijetesë të popullit shqiptar, i cili nëpërmjet lidhjes me tokën e të parëve, me familjen si shtyllë qendrore e morale, përmes kodeve të tij tradicionale dhe identifikuese, arrin që të sigurojë mbijetesën përballë rreziqeve të njëpasnjëshme nga pushtuesit që vijnë ndryshe – ndryshe, madje edhe si çlirimtarë...

Edhe romani *Kush e solli Doruntinën*, i ndërtuar si dramë mbi legjenden mesjetare shqiptare, për shumë arsye, qoftë edhe fjalën e dhënë dhe mbajtjen e saj, besën, mbetet kod në letërsinë shqipe.

Edhe pse vitet kanë ikur me shpejtësi rrufe, mësimet dhe njohuritë për legjendën, për baladën dhe për veprën e ngritur mbi të, janë pasuruar gjithnjë e më shumë, bashkë me përpjekjet tona për të përçuar porosinë e përjetshme të dashurisë njerëzore por edhe fateve dhe tragjedi që mbesin pjesë përbërëse e jetës, në të gjitha epokat dhe periudhat historike të zhvillimit.

Ndaj nuk mund ta fsheh, se një kërkese brenda përbrenda vetës sime për të ditur dhe studiuar edhe më shumë veprën, *Kush e solli Doruntinën*, në rastin më të fundit në kuptimin e intertekstualitetit, përfundimisht i dha shtytje e guxim, mentorja e këtij punimi, profesoresha ime e nderuar, Dr. Meral Veseli, e cila, në çdo kohë e pa ngurim, më ka ndihmuar që përmes rekomandimeve të saja profesionale, vërejtjeve të caktuara, dhe sidomos këshillave rreth punës kërkimore e metodologjike të formësoj përpjekjet e mia për përfundimin e kësaj teme.

Jam i vetëdijshëm se tema të cilën e përzgjedhëm bashkë me mentoren time, **intertekstualiteti** si fenomen, por veçmas në romanin *Kush e solli Doruntinën*, kërkon punë dhe përkushtim të madh edhe për faktin se edhe sot e kësaj dite nuk është trajtuar sa duhet në letërsi, në krahasim me temat tjera. Prandaj edhe dëshira për të sjellë një risi, sado e vogël qoftë, është shumë e madhe.

Është themeltare që në rastin tonë, gjatë trajtimit të kësaj teme të kemi njohuritë bazë, se, çdo tekst letrar nuk është asgjë tjetër pos një pasqyrim i një teksti tjetër. Në një mënyrë çdo tekst është një lloj intertekstualiteti që për shumicën tonë është gjë e natyrshme se në letërsi nuk ka tekst unik i cili nuk mbështetet në një tekst tjetër. Një mënyrë e re e të parashtruarit të një teksti është **intertekstualitet**, dukuri për të cilën do të bëjmë përpjekje të pakursyera të nxjerrim në shesh dhe shpjegojmë gjatë studimit të romanit të Kadaresë, *Kush e solli Doruntinën*.

Natyrisht që trajtimi i kësaj teme në punimin tonë nuk do të përshkohet vetëm nga një drejtim. Punimi do të ndahet në kapituj të veçantë. *Krahas intertekstualitetit i cili e arsyeton krijimin e një teksti të ri në frymën e një teksti të vjetër, madje duke e zbërthyer në mënyra të ndryshme se si ndërtohet një krijim i tillë, gjithashtu, puna jonë kërkimore do të përqëndrohet edhe në rëndësinë e përdorimit të motivit dhe mitit të ringjalljes në romanin, *Kush e solli**

Doruntinën ... (<https://www.coursehero.com>, n.d.) Miti në këtë rast është intertekst universal që ka për bazë temën e ringjalljes, me qëllim të mbajtjes së fjalës së dhënë.

Dhe një gjë është e vërtetë; Legjenda e Konstandinit dhe Doruntinës është një mrekulli në vete, është një margaritar i folklorit shqiptar dhe mjeshtri e krijimit popullor. Jacob Grimm shkruante në kohën e tij se;” *kjo legjendë është një nga këngët më tronditëse të popujve në të gjitha kohërat*”. (www.portalishkollor.al). *Legjenda gjendet edhe në folklorin e popujve tjerë, veçanërisht atyre ballkanikë, në trevat e shtrira nëpër Shqipëri, Greqi, Bullgari, Bosnjë etj, ndërkohë që nga kënga gjermane "Leonore" me po të njëjtën temë, është shkruar në shek.XIX nga një poet gjerman August Bürger e që është një krijim i mëvonshëm.* (www.portalishkollor.al). *Se është një nga krijimet (legjendat) më të vjetra shqiptare vërtetohet edhe me faktin kur në vitin 1875 konsulli francez, posa e kishte dëgjuar e botoi në përmbledhjen e tij "Contes albanaises" (Tregime të moçme shqiptare).* (www.portalishkollor.al). *"Rilindasi Thimi Mitko e gjeti këtë legjendë tek arbëreshët e vendosur nën titullin "Udhëtimi i Kostandinit të vdekur", ndërkohë që Dhimitër Kamadra e ka botuar me titullin "Kostandini dhe Doruntina". Kësaj legjende të vjetër shqiptare një jehonë të veçantë i bëri edhe Dora d'Istria në esenë e saj, "Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore" të botuar në Francë në vitin 1866* (www.portalishkollor.al). *Dhe si e tillë nuk mund të caktojme vjetërsinë, por detyra jonë është të gjejmë raportin e legjendës me veprat që janë ndërtuar mbi bazën e saj, më saktësisht veprës së Kadares me legjenden shqiptare. Të rrallë janë ata letrarë e artistë që nuk janë frymëzuar nga kjo legjendë; për pjesët teatrale, kompozimet muzikore, veprat në artin figurativ dhe për romanet e tyre. Siç e kemi rastin e ndërtimit mjeshtëror të romanit - kryevepër të Ismail Kadaresë, "Kush e solli Doruntinën". Prandaj, gjithmonë jemi frymëzuar nga kjo krijimtari letrare në radhë të parë, por gjithësesi edhe nga krijimtaria e pasur dhe e bollshme gojore, në këtë rast për njërën ndër legjendat e vjetra shqiptare "Kush e solli Doruntinën", veprë kjo që kësaj radhe është edhe objekt i trajtimit tonë.*

Në veprat e tij madhështore, e sidomos në novelën *"Kush e solli Doruntinën"*, Ismail Kadare ka huazuar tema nga historia e pasur e folklorit shqiptar dhe jo vetëm, nga tregimet, baladat dhe mitet dhe çdo gjë tjetër e përcjellur brez pas brezi si kulture e trashëgimi, në mënyrë që me mprehtësinë e mendimit të krijoj botën e tij narrative. *"Bota e Ismail Kadaresë është një lloj anti-materie. Ajo mund ta shkatërrojë tonën. Vetëm se ndryshe nga ç'ndodh me grimcat*

elementare në fizikë, bota e tij plotëson tonën duke lënë gjurmë të jashtëzakonshme". (Jeta e re, 2011, f. 6) .

KREU I

1.1. Jeta dhe vepra e Ismail Kadaresë

I lindur në Gjirokastrë në vitin 1936, Ismail Kadare është njëri ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë, prozatori më i popullarizuar shqiptar, vepra letrare e të cilit deri më sot është e përkthyer në rreth 45 gjuhë të ndryshme. Falë, vlerës artistike në radhë të parë, numrit të jashtëzakonshëm të veprave letrare dhe gjurmëve që ka lënë në letërsi, sidomos në paqyrimin e Shqipërisë në botë dhe prezentimin e letërsisë së saj, me të drejtë është quajtur dhe vlerësuar si "*ambasador i letërsisë shqiptare*", "*gjeneral i prozës* ", "*korife i letërsisë së sotme shqipe*"etj.

Vepra letrare e Kadaresë në poezi dhe në prozë, e cila është frymëzim jo vetëm për studiuesit e letërsisë, qofshin ata shqiptarë, apo jo, ajo ka zgjuar dhe zgjon vazhdimisht kureshtjen e lexuesve dhe interesimin e kritikës letrare gjithandej. Çdo vepër e tij letrare pothuajse në të gjitha rastet, e botuar në shumë e shumë gjuhë të botës, është pritur e mirëpritur me interesim të madh, madje me padurim, e sidomos nga adhuruesit e panumërt të fjalës artistike.

Kadare bënë pjesë në radhën e atyre shkrimtarëve, shumë të veçantë, për fatin më të mirë të kohës sonë, që me veprat dhe botimin e tyre kanë sjellur risi në letërsi duke e përmbushur pritjen dhe shijen e lexuesit dhe interesimin e kritikës letrare. Është mbase shumë e vështirë të pyesim se kë e adhuron lexuesi me shumë; prozën apo poezinë e tij!? Sepse edhe njëra edhe tjetra kanë udhëtuar e bashkëjetojnë, si dy motra të panadara. Pavarësisht se hapat e para autori i hodhi në poezi, ndërsa volumin e veprës në përfundim të karrierës së tij të bujshme e ka në prozë.

Sidoqoftë, veprimtarinë letrare Ismail Kadareja e nisi si poet, për ta vazhduar pastaj si prozator, pa hequr dorë asnjëherë nga ëndërrimet rinore - *poezia*, ëndërrime të cilat në vitin 1954, kur ishte vetëm 18 vjeç, si nxënës i gjimnazit botoi përmbledhjen e tij të parë, *Frymëzime*

djaloshare, duke paralajmëruar kështu talentin e jashtëzakonshëm që po vinte. Këtë shumë shpejt do ta vërtetoj botimi i vëllimit, *Ëndërrime*, 1957 me të cilin poeti, edhe pse nuk ishte çliruar ende nga çalimet fillestare krejtësisht të pranueshme, bëri hapin e radhës në drejtim të formimit të individualitetit krijues. *Në vitin 1961 Kadare botoi vëllimin tjetër me vjersha dhe poema, Shekulli im për të vazhduar krijimtarinë e tij letrare e artistike me poemën, Përse mendohen këto male, të botuar në vitin 1963.* (www.sinjali.com, a.d.)

Por, do të jetë novela *“Qyteti pa reklama”* (1965) përmes së cilës autori paralajmëroi se bindshëm do të bëj historinë në letërsinë shqiptare.

Në vetëdijen dhe përfytyrimin e lexuesve shqiptarë të viteve '60- të, Ismail Kadare (rreth 20 vjeç) ishte poeti, i cili i kishte tundur seriozisht themelet e poezisë së vjetër, "të deklasuar", të poezisë anemike tradicionaliste, që qëndronte, disi larg jetës së gjallë dhe kohës së vet dinamike. Ishte poeti, i cili po sillte në poezinë shqipe një frymë të re, duke portretizuar fytyrën e atdheut socialist dhe fizionominë e njeriut me botëkuptim të ri, si dhe ritmin dinamik të shekullit XX-të dhe të atmosferës së tendosur në botë, kur *"Përleshjen e shkulen për flokësh si gratë agjensitë e lajmeve.* (Kadare, *Motive me diell*, 1968, f. 57)

“Në kohën kur e botoi romanin e tij të parë, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, me të cilën "pushtoi" tërë botën (Gjenerali... i tij është përkthyer në më se 30 gjuhë), kritika letrare në Shqipëri shkruante për të si për prozën e një poeti”. (Brahimi R. , *Shënime letrare*, 1965, f. 255). Lexuesit shqiptarë në Shqipëri deri në atë kohë e njihnin kryesisht si poet, ndërsa lexuesit shqiptarë përtej kufirit të shtetit amë sapo kishin filluar ta njihnin. Në letërsi sot e gjithë ditën Gjenerali.....mbetet *si njëra ndër veprat kyçe që peshojnë mendimin dhe botën kadariane.* Pra bashkë me Gjeneralin... Kadareja u bë i njohur fillimisht në nivelin kombëtar përgjithësisht dhe si i tillë me hapa të sigurtë, falë krijimtarisë së pandërprerë letrare e pati shumë më të lehtë rrugëtimin drejt majave të letërsisë evropiane e botërore. Dhe, ky rrugëtim a ngritje e sigurtë është rrjedhë e natyrshme edhe për faktin se në asnjë rrethanë shkrimtari, poeti, apo artist nuk mund t'iu takoj të tjerëve pa e njohur e pa i takuar vetës së tij. Kjo është dëshmuar më së miri në veprën dhe krijimtarinë e Kadaresë, i cili krahas prires dhe talentit të madh në letërsi, pati njohje të jashtëzakonshme edhe mbi të kaluarën, historinë, kulturën dhe traditën për popullin që i përkiste. Mbase, të gjitha këto elemente janë të ndërlidhura dhe bashketojnë në opusin e tij letrar. Ismail Kadare deri më sot ka shkruar më se 30 vepra në poezi e prozë, shumica e të cilave

janë botuar e ribotuar nga disa herë, kurse së bashku me përkthimet në gjuhë të huaja, të cilat nuk janë pak (45) dhe për të cilat nuk kemi një pasqyrë të plotë, (Jaka Y. , 1979) ato mbushin një bibliotekë të tërë. Pas “Përbindëshit” (1965) dhe “Lëkura e daulles” e botuar më vonë në titullin “Dasma” (1968), në po të njëjtën kohë Ismail Kadare do të botoi edhe romanet “Kronikë në gur” dhe “Kështjella”, ndërsa në vitin 1973 ai boton edhe dy romanet tjera; “Dimri i madh” dhe “Nëntori i një kryeqyteti”, përmbajtja e të cilave deri diku e parandaloj skenarin tragjik që fare lehtë mund t’i ndodhte në Shqipërinë e atëhershme komuniste.

Dhe si rezultat i gjithë kësaj, krijimtaria e tij letrare veç sa vjen e rritet edhe me vepra të tjera siç janë; “Breznitë e hankomatëve” (1977), Triptik “Ura me tri harqe” (1978), “Pashallëqët e mëdha” (1978), “Muzgu i përendive të Stepes (1978) “Prilli i thyer” (1978), “Qorrfermani” (1984), “Kush e solli Doruntinën” (1980), “Dosja H.” (1981), “Viti i mbrapsht”(1985), “Koncert në fund të dimrit” (1988),“ , “Sjellësi i fatkeqësisë” (1994).

Zhvillimet e viteve të 90-ta në Shqipëri, pashmangshëm që do të ndikojnë edhe në shkrimtarin tashmë të njohur në arenën ndërkombëtare, Ismail Kadare. Kësaj thyerje historike shqiptare nuk mund t’i shpëtonte dot as njeriu që në një mënyrë kishte ndikuar që të ndodhte ky ndryshim i madh. Këto ngjarje që pasqyrojnë Shqipërinë e atyre ditëve dhe përpjekja e autorit për ringritje të re apo për një ripozicionim të ri përballë të kaluarës në ish sistemin e kohës tashmë i njohur për të gjithë. Kështu që veprat si: Spiritus, Pramida, Tri këngë zie për Kosovën, Lulet e ftohta të Marsit, Aksidenti, E penguara dhe Darka e gabuar, do të pasqyrojnë më së miri këmbënguljen e autorit për të dëshmuar veten si disident dhe kombin shqiptar si qytetërim evropian. Dhe këtij qëllimi madhor, mendojmë ne, Kadareja ia ka arritur plotësisht. Edhe pse për këtë të dytën, pra për identitetin e shqiptarëve në raport me atë evropian studiuesja dhe albanologja kineze ka nxitur debat, kur pasi që konstaton se: *Këto vepra janë një deklaratë e fortë e kundërshtive dhe shëndërrimeve që pësoi shkrimtari dhe të cilat lidhen kryesisht me dy arsye: me përpjekjet e Kadaresë për ta vizatuar veten si disident i regjimit komunist dhe së dyti, përpjekja për të siguruar se shqiptarët janë gjeneologjikisht evropian* (Myzeqari, Ligjerimi feminist te vepra e Ismail Kadarese, 2013, f. 24), thotë: *Kadareja për mua, kur bën krijimin letrar, është një gjeni, nuk ka asnjë pikë që mund ta kritikojë. Por kur del ndonjëherë në intervistë, ose që shkruan ndonjë ese, për mua për shembull çfarë ka shkruar për identitetin evropian të shqiptarëve, aty nuk ka argumente aq të forta nga pikëpamja shkencore.* (Jing,

Shqipëria.com, 2016). Dhe pyetja më legjitime që mund të shtrohet në këtë rast për znj. Jing, është se; në cilat kundër-argumente e ka të bazuar konstatimin e saj? Kur botërisht është e njohur dhe e pranuar, përveç kundërshtarëve të papërmirësueshëm, se shqiptarët jo vetëm që historikisht janë pjesë përbërëse e Europës, por se janë ndër banuesit më të vjetër të saj, e që ndër shekuj kanë kultivuar frymën e civilizimit dhe përparimit njerëzor, siç është edhe rasti i njërit prej përfaqësuesve më të denjë të këtij identiteti evropian, gjeniut letrar, Ismail Kadare.

Ndërsa vet Kadare mbase vendos vulën e së vërtetës mbi këto “dilema” kur thotë: S’mund të ketë Shqipëri jashtë qytetërimit evropian. *“Populli i dëbuar që është populli shqiptar duhej të dëbohej me forcë, me ndarje, me shpërngulje, me denatyrim, duke provuar të gjitha mënyrat. Madje për parantezë: gjuha shqipe në Europë është e vetmja e ndaluar me ligj për shekuj të tërë. Nuk ka ndonjë gjuhë tjetër indo-evropiane që është e ndaluar si shqipja dhe kjo ende nuk është shpjeguar nga historiografia shqiptare”*

Krijimtaria e Ismail Kadaresë paraqet sot një tërësi të jashtëzakonshme letrare të letërsisë shqipe në brumin e kërkimeve të vazhdueshme pikëpamjesh, konceptesh e vlerash letrare - artistike e cila është në shërbim edhe të një qëllimi të veçantë estetik, qoftë nga aspekti përmbajtësorë, poashtu edhe nga aspekti i riprodhimit të përkryer artistik, sidomos gjatë krijimit dhe ndërtimit të personazheve në veprat e tija, e në mënyrë të veçantë në romanin, *Kush e sollti Doruntinën*.

“Asnjë fushë dhe asnjë lloj gjendjeje shpirtërore nuk është e huaj për gjeninë krijuese të Ismail Kadaresë, që është pa dyshim shkrimtari më i begatë dhe më i larmishëm i kohës sonë”. (Bosquet, 2011, f. 112).

Apo siç shprehet Gj. Shkurtaç; *“Larushia e temave dhe mënyra që i trajton, dimensionet dhe natyraliteti i tyre në nuk do mend se pashmangshëm e kanë rritur edhe interesimin e studiuesve dhe kritikëve letrar për të marrë me veprën shkrimtarit, Ismail Kadare”*.

Veprat letrare e Ismail Kadaresë paraqet sot një nga korpuset më të rëndësishme të letërsisë shqipe, ndërsa poezia në kuadër të saj - një vatër interesante kërkimesh, pikëpamjesh, konceptesh e vlerash letrare artistike. Veprën e tij duhet ta konceptojmë si një sistem apo strukturë shenjash, që i shërben një qëllimi specifik estetik, ta analizojmë si nga aspekti përmbajtësor, aspekti imazhologjik dhe kulturologjik, që idetë, emocionet që na përcjell

personazhi, pra elementet më tipike nëpërmjet të cilave shprehet një tipologji unike e cilë të përfton me plot delikatesë për ti takuar plotësisht.

Romani **Kush e solli Doruntinën**, (1979) ndërkaq është një ndër kryeveprat e këtij kolosi të letrave shqipe. Ndërtimi i të cilit është bërë pothuajse në mënyrë të përsosur *duke e pasur si hipotekst baladën* dhe Eposin e pasur shqiptar.

1.2. Vlerësime për Kadarenë

Vepra letrare e Ismail Kadaresë është vlerësuar dhe vlerësohet lartë jo vetëm në hapësirën letrare shqiptare, por gjithandej globit. Si e tillë ajo sot paraqet sot përfaqësimin më origjinal të letërsisë shqipe në botë. Ja se si e përshkruajnë figurën e tij shkrimtarë, kritikë dhe autoritete të njohura ndërkombëtare.

Në të gjithë botën, veprat e Kadaresë kanë një domethënie të fuqishme, therëse.” **Alain Plantey, President i Akademisë Franceze.**

“Me një rën këmbë në Shqipërië e moçme, gojore dhe legjendare, ende në rrëqethjen homerike dhe me këmbën tjetër me modernitetin më të spikatur dhe më finok, Kadareja gjendet në kapërcyell të të dy botëve dhe nga kjo rrethanë e jashtëzakonshme vepra e tij krijon akorde të fuqishme dhe të goditura.” **Dominique Fernandez.**

“Piramida e Kadaresë- një parabolë e paranojës dhe terrorit, mund të krahasohet me veprat e Kafkës, të Paul Asterit dhe të Elias Canettit...Është një nga romancierët më të shquar, që tashmë botohet në çdo gjuhë” **Bruce Baëer.**

*Kadareja ia del jetë universal dhe i të gjitha kohërave, duke mbetur gjithaç shqiptar.”***Nicole Zand.**

“Asgjë nuk mund të përballet me penën e hidhur të Kadaresë që, vërvit mbi historinë njerëzore sgpërthimin e një të qeshure shekspiriane. Kina e Kadaresë (Koncerti) me figurantët dhe sozitë e saj, është krejt e njëmendtë. Ddhe kaq e stërmadhe , saqë grotesku fiton përmasa kozmike”.

Andre Clavel.

“Dëshmi e Shqipërisë, dëshmi për Shqipërinë, Kadareja është bërë universal.” **Maurice Droun.**

“Vepra e Kadaresë është një nga veprat më origjinale dhe më të shquara të këtij shekulli.” **Eric Faye.**

“Proza e Kadaresë vezullon me realizmin magjik të Gabriela Garsia Markuz- it.” **Los Angeles Times Bokk Revieë** “E

kanë krahasuar me Gogolin, me Kafken me Orëelin. Por, ai i Kadaresë është zë origjinal, universal, e prapë me rrënjët thellë në tokën e vet.” **Shusha Gappy**

“Gjëja më ideale në letërsi është kur lexon diçka të sapobotuar dhe e kupton që kjo do të bëhet klasike. Kjo gjë ideale ka për titull përmbledhjen “Përballë pasqyrës së një gruaje” dhe i përket më të madhit shkrimtar të gjallë të kohës: Ismail Kadaresë.” **Guillaume Allary**

“Kadare është i rrahur në të gjitha dallgët e artit modern bashkëkohorë. Veç se ai gëzon avantazhin e madh që kurrë të mos ketë pasur nevojë ta çajë kokën për recensentët gjermanë. Ai ka mundur ta mbrojë veshjen e artit të tij nga të gjithë luspat e shëmtuara të “izmave” zhurmëmëdha, aq shumë të çmuara prej “doktorëve” tanë të kritikës... Vepra e tij, sa çështë ushqim shpirtëror, po aq është edhe art sublim.” **Michael Cleeborg**

Lexuesi amerikan sapo mori në dorë një romanin e ri të mrekullueshëm të Ismail Kadaresë” *Lulet e ftohta të marsit”.* **Jonathan Levi** (<http://flurudha.blogspot.com> & Zejneli, 2016)

Dhe jo rastësisht këto vlerësime për Ismail Kadarenë, letrar in shqiptar që po i mungon vetëm një çmim, po i përmbyllim me këto thirrje me peshë:

“Çdo vit, pothuaj gjatë dhjetëvjeçari, Kadareja u ka dhënë lexuesve të vet nga një roman, që i befason dhe i shtang ata, i prek në shpirtë, u ngjall ndjenja e mendime të thella... Ka ardhur koha që Kadareja ta marrë çmimin që meriton... Jepjani Kadaresë çmimin Nobel!” **Magazine litteraire**

“E kemi thënë më parë dhe do ta themi: ur do ta njoh Stokholmi kalibrin e jashtëzakonshëm të këtij shekulli.” **Figaro Litteraire Paris** (<http://flurudha.blogspot.com> & Zejneli, 2016)

*“Sado e ndryshme që të jetë **Shqipëria** nga Suedia apo Franca, ajo ka nxjerrë në dritë një gjeni. Kadareja njohet në të gjithë planetin; të kurorëzosh Kadarenë nuk do të thotë ta emanciposh atë: do të thotë të emancipoheni vetë ju.”* **Alain Bosquet (Letër drejtuar jurisë së çmimit Nobel)**

KREU II

2.1. Intertekstualiteti

2.1.1. Ç'është intertekstualiteti?

I vendosur, sot, si nocion mbizotërues në kritikën letrare, *intertekstualiteti* është lëvizja përmes së cilës shkruajmë një tekst tjetër duke e marrë për bazë një tekst tjetër pararendës. Ose thënë ndryshe; intertekstualiteti paraqet ndikimet e një teksti të caktuar në tekste të tjera. Me një fjalë çdo libër lind dhe ndërtohet nga një vepër tjetër. Intertekstualiteti pra, është lëvizja nga e cila një tekst rishkruan një tekst tjetër, ndërsa interteksti paraqet tërësinë e teksteve të një vepre, qoftë duke iu referuar në mungesë kur kemi të bëjmë me ndonjë mendim të mbuluar brenda në tekst (aluzion), qoftë në prani të tij kur kemi të bëjmë me citim.

Me intertekstualitet (intertekst) kuptojmë efektet e një teksti në tekste të tjera.. Intertekstualiteti si metodë për interpretim në tekstin kritik prodhohet në formën e; citatit, lajmit, shënimit, retrospektivës, biograficizmit, historicizmit e të tjera, të cilat dëshmojnë vetëdijen e lartë kritike e estetike, dhe qasjen postmoderniste në ndërtimin e teksteve të saj. Studiuesi, Roland Barthes thotë se: “kur jemi duke lexuar një vepër, shpesh na duket se dikë të tillë e kemi lexuar edhe më parë dhe kjo nënkupton intertekstualitet. Kjo deja vu tashmë e lexuar që na shfaqet gjatë aktit të leximit provokon aktin e kërkimit intertekstual”. (Symbol, f. 41) Me një fjalë, nuk ka tekst pa intertekst. Shpesh teksti na përcjell paralajmërime të fshehura, të cilat janë shumë të vështira për t'u përkapur.

Intertekstualiteti është një fenomen i ngjashëm pothuaj në çdo tekst letrar. Janë dy momente kryesore të cilat na dalin të shpërfaqura në tekstet që i lexojmë apo në veprat e sotme moderne: **citimi i drejtpërdrejtë apo i hapur i një autori*

** pjesë të ndërkallura në tekstin origjinal*

Qëllimi themelor i intertekstualitetit është që të parashtrojë një mënyrë të re leximi dhe interpretimi i cili përfshinë një larmi të madhe praktikash dhe formash për të cilat do të flasim gjatë trajtimit të kësaj teme.

Nocioni i intertekstualitetit, i parashtruar nga **Julia Kristeva**, nxjerr krye në diskutimin kritik nga fundi i viteve gjashtëdhjetë dhe shpejt zë vend duke u bërë kështu kalim i detyruar për çdo analizë letrare. Nëse ai shfaqet si thelbësisht modern, ai mbulon megjithatë praktika shkrimi sa të hershme aq dhe themelore: asnjë tekst nuk mund të shkruhet pavarësisht asaj çka ka qenë shkruar tashmë dhe ai mbart, në një mënyrë pak a shumë të dukshme, gjurmën dhe kujtesën e një trashëgimie dhe të traditës. *“Intertekstualiteti do të ishte atëherë, ndoshta fare i thjeshtë dhe në mënyrë të rëndomtë, fakti që çdo shkrim gjendet gjithmonë midis veprave që e paraprinë atë dhe fakti që nuk është asnjëherë e mundur për ta fshirë letërsinë”*. (Piegay, 2011, f. 13). Ose: *“Të përvijosh udhën drejt zanafillës së intertekstualitetit, kjo është të tregosh se kundër çfarë formash leximi kritik është ngritur ai. Sepse nëse intertekstualiteti mbulon praktika po aq të vjetra sa dhe ndërtuese të letërsisë, ai pretendon të thyhet me mendimin e përcjelljes dhe të traditës letrare”*. (Piegay, 2011, f. 35)

Përkufizimin që ne kemi parashtruar, thotë autorja, është minimal, nga që i përgjithshëm, sepse : *“ai përfshin jo vetëm ndërfaqje, të hapura apo të fshehta ndërmjet veprave, por edhe dukuri të shpërndara rishkrimi, madje hamendësime për nga ngjajshmëria”*. (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013). Për më tepër autorja Isufaj thekson: *“I kuptuar kështu, intertekstualiteti shtron, pra, në mënyrë të mprehtë problemin e pikasjes dhe të caqeve të intertekstit”*. (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013). Mirëpo kjo çështje e pikasjes dhe e konturave brenda dukurive intertekstuale nuk mund të shtrohej në këndvështrimin e Julia Kristevës, kur ajo e ka përkufizuar nocionin e intertekstualitetit.

2.2. Intertekstualiteti si dinamike tekstuale

Kur, Julia Kristeva e përkufizon nocionin e intertekstualitetit, *Semiotika* (Le Seuil, 1969), ajo e dallon atë rrënjësisht nga një objekt i ndërtuar si ti tillë, lehtësisht i njohshëm dhe i vrojtueshëm. (Piegay, 2011, f. 19). Për autorën e poetikës intertekstuale, interteksti është thelbësisht një përkëmbim tekstesh. *“Teksti poashtu është një prodhimtari ku bashkohen*

prodhuesi i tekstit dhe lexuesi i tij. Lidhur me këtë, Kristeva citon Roland Barthes: Ai shkatërroi gjuhën e komunikimit, paraqitjes apo shprehjes (aty ku kryefjala, individ apo kolektiv mund të ketë iluzionin që ai po imiton apo po shprehet) dhe rindërton një tjetër gjuhë”. (Piegay, 2011, f. 21).

Në këtë mënyrë përfitohet një ndërveprim i dyfishtë ndërmejt tekstit dhe lexuesit nga njëra anë, dhe, ndërmjet tekstit - shkrimit - gjuhës, në anën tjetër. Si i tillë teksti, ashtu siç e përkufizon Julia Kristeva në kuadër të teorisë së tij, është thelbësisht një intertekst. Roland Barthes, në metodën e tij studimore kur flet për teorinë e tekstit, shkruan: “*çdo tekst është një intertekst; të tjera tekste janë të pranishme në të, në nivele të ndryshme, në forma pak a shumë të njohura, siç janë: tekstet e kulturës së mëparshme dhe tekstet e kulturës përreth; çdo tekst është një thyerje e re citimesh të kaluara. Të rishpërndara në të, në tekst kalojnë copëza kodesh, formula, modele ritmike, segmente gjuhësh shoqërore*”... Sipas Roland Barthes: “*Interteksti është një fushë e përgjithshme formulash anonime, zanafilla e të cilave rrallë mund të vrojtohet, citimesh të pavetëdijshme apo automatike të dhëna pa thonjëza*”. (Piegay, 2011, f. 23)

Së këndejmi, intertekstualiteti nuk është i menduar si dukuri imitimi, nuk dërgon as te rimarrja e një vepre nga e kaluara, as te një referencë e përmbajtur në një tekst, por tek lëvizja e cila vepron duke trazuar shprehje të mëparshme. Ashtu siç edhe ka vlerësuar Laurent Jenny në librin, Strategjia e formës, “*Interteksti flet një gjuhë, fjalori i së cilës është shuma e teksteve ekzistuese*” (Jenny, 1976, f. 27). Me një fjalë, në qoftë se letërisa është kryekëput ndërtekstuale, kjo nuk qëndron vetëm pse çdo tekst njihet në tërësinë e teksteve tjera, por sepse shkrimi (teksti) gjendet në të njëjtin rrafsh me tërësinë e ligjërimeve që e rrethojnë.

2.3. Intertekstualiteti si sistem marrëdhëniesh

Intertekstualitetin si një sistem marrëdhëniesh, të tillë e përkufizon autori Gerard Genette, në veprën e tij, “Hyrje në arkitekst” kur thotë se: “*intertekstualiteti nuk është një element qendror, por maëdhënie midis të tjerash; intertekstualiteti ndërhyr në zemrën e një rrjeti, i cili e përkufizon letërsinë në veçantinë e saj*”. (Genette, 1982). Në të vërtetë, për studiuesin Genette, ajo çka e themelon tetraaritetin e (përkufizuar nga Roman Jakobson si; (ajo çka e përbën një vepër të dhënë një vepër letrare) është tërësia e kategorive të përgjithshme apo tipa ligjërimi, mënyra e të shprehurit, lloje letrare, e ku fytyret çdo tekst i veçantë (Palimpseste, Le Seuil, 1982). “Ky

studim për Genetten gjithashtu përcakton objektin e poetikës i cili nuk është siç e përmend që në hyrje të Palimpsestes, teskt i vështruar në veçantinë e tij, por transtekstualitet i cili përfshin këto tipe mrrëdhëniesh: arkitekstualiteti, paratekstualiteti, metatekstualiteti, hipoteksti dhe hipertekstualiteti”. (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013)

2.4. Interteksti si formë terrorizmi i referencës (terrori në letër të bardhë)

Të përkufizosh intertekstualitetin nga leximi, kjo mundet gjithashtu, ta shndërroj leximin në një përskrim mjaft shtrëngues, ku interteksti ushtron një formë terrorizmi: në fakt, ai nuk është më çka unë mund të shquaj apo dalloj, krejt i lirë, por çka duhet të pikas. Sipas këtij këndvështrimi, kështu e përkufizon intertekstualitetin, Michael Riffaterre: *“Intertesktualiteti është shquarja nga ana e lexuesit, e raporteve ndërmjet një vepre të dhënë dhe veprave të tjera, që e kanë paraprirë apo pasuar. Këto vepra të tjera e përbëjnë intertekstin e së parës”*. (La Pensee, 1980, f. 215). *“I vetëdijshëm mbi relativizmin tek i cili përcjell detyrimisht një përkufizim të tillë, Riffaterre vendos përballë njëri- tjetrit intertekstualitetin e rastësishëm dhe intertekstualitetin e detyruar në mënyrë që “lexuesi nuk mund të mos e shquaj sepse interteksti lë në tekst një gjurmë të pashlyeshme, një konstantë (njëtrajtshmëri) formale e cila e luan rolin e një urdhërimi leximi”*. (La Pensee, 1980, f. 215). Duke qenë kështu mund të themi se përveç tjerash, interteskti përfaqëson një metodë përzgjedhjeje e cila bën ndarjen në mes lexuesve të aftë, të cilët do të jenë në gjendje të njohin intertekstin, dhe në anën tjetër lexuesve të thjeshtë të cilëve natyrisht nuk do t’iu bjerë në sy prania e një gjurme intertekstuale në tekst. Si i tillë, pra nëse e shohim nga ky këndvështrim intertekstualiteti është krejtësisht i varur nga leximi.

2.5. Tipologjia e intertekstualitetit

2.5.1. Marrëdhënia e bashkëpranisë

Sipas studiuesit të shquar, Genett – es, ne dallojmë dy tipe marrëdhëniesh intertekstuale: marrëdhënie të *bazuara mbi një marrëdhënie bashkëpranë*, ndërmjet dy e më shumë teksteve (marrëdhënie në të cilat autori i Palimpsestes e mbyll intertekstualitetin) dhe ato të *bazuara mbi një marrëdhënie prejardhjeje*. Ndryshe këtu kemi të bëjmë me marrëdhënie të fshehta dhe marrëdhënie të hapura që gjithmonë rrinë përballë njëra-tjetrës.

2.5.2. Citati si intertekst

Forma më emblematike e intertekstualitetit ku është i përfshirë teksti në një tekst tjetër, padyshim është *citimi*. Përmes kësaj forme të ndërtimit apo shkruarja me kujdes e një teksti të ri i bazuar në një apo shumë tekste të tjera, qofshin ato edhe tregime, rrëfime, balada apo legjenda, siç do të kemi rastin në vazhdim të këtij punimi përmes studimit të intertekstualitetit në romanin

Kush e solli Doruntinën, ne, mund të përpilojmë dhe përfundojmë shumë më saktë një tekst të ri e mbi të cilin natyrisht që do të kemi edhe intertekstualitetin si formë apo pjesë e pandarë e cilit do tekst. Intertekstualiteti parasegjithash ndërtohet mbi lajmin, citatin dhe kategori të tjera kritike, letrare e stilistike. Si njëra nga format e interpretimin të teksteve letrare, sot *citati* përdoret nga të gjithë studiuesit e letërsisë. Kjo është fare e dukshme në të gjitha punimet shkencore që i nxjerrin ata. Kështu gjatë studimit kritik të një vepre letrare citati veç sa ia shton vlerën asaj. Përzgjedhja dhe përdorimi me vend i citatit poashtu temën për të cilën flasim bënë shumë më përmbajtësore duke e bërë gjithnjë e më të kuptueshme pasi që e ka tjeshtësuar në masën e duhur. Këtë e shpjegon edhe Nathalie Piegay-Gros kur citon Gallimardin në “Lutjen e Shën Jeronimit”. “Një citim i zgjedhur mirë e pasuron dhe e ndriçon paragrafin ku ai shfaqet si një rreze dielli e që pasuron një peisazh: “rrezet e fundit të pasditës që përvijojnë, saktësojnë,

madje zbukurojnë peisazhe të zhveshura dhe monotone si malet e Epirit të vështruara nga deti apo ne, dhe nga gjiri i Korfuzit”. Vet fakti që ky varg, kjo fjali ndërmjet thonjzash vjen nga gjetkë, e zgjeron horizontin intelektual që unë ravijëzoi përreth lexuesit. Ai është një thirrje ose përmendje, një bashkëbisedim i vendosur: e tërë poezia, i tërë thesari i letërsisë të përmendur shkurtimisht, të vënë në marrëdhënie me veprën time në mendimin e atij që e lexon”. (Piegay, 2011, f. 66). Për këtë qëllim, përpjekjet tona gjatë shtjellimit të temës sonë të përzgjedhur, Intertekstualiteti në romanin *Kush e solli Doruntinën*, përveç tjerash, edhe ne do të mbështetemi vazhdimisht mbi citate dhe analiza tekstesh, pra, duke iu referuar një teksti të mëparshëm, në mënyrë që lexuesi të kuptoi jo vetëm praninë e intertekstit, por edhe të pajiset me njohuritë e mjaftueshme, për t’i shpjeguar, pastaj, pas asnjë problem pasojat e ndërhyrjes së tij.

2.5.3. Metateksti

Metateksti si nocion për interpretimin e teksteve letrare në diskursin kritik është mjaft i shpeshtë. Në diskursin kritik metateksti paraqet praninë e komentit që i lidhë dy tekste. Kjo ndodhë kur autori i një vepre të caktuar i përdor njëkohësisht dy tekste që komunikojnë dhe bashkëveprojnë, pa asnjë problem, njëri me tjetrin dhe mbi këto dy tekste e ndërton komentin apo narracionin e tij. Si rrjedhë e kësaj, metateksti ndërtohet mbi një gjuhë të figurshme e metaforike, por jo metonimike. Vetëm në këtë mënyrë të gjitha këto elemente për metatekstin do të arrihen me sukses dhe me nivel të lartë artistik.

2.5.4. Referenca si intertekstualitet

Njëra ndër format e hapura të intertekstualitetit gjatë një shkrimi apo studimi shkencor, në mënyrë të veçantë gjatë shkrimit të një teksti, është edhe referenca. Pa të, është e pamundur që të kemi një studim të mirëfillt të një vepre letrare. Është shumë me rëndësi të thuhet se referenca nuk e *nxjerr në pah* tekstin tek i cili e dërgon. Në këtë mënyrë referenca mbetet një marrëdhënie e munguar. Por, gjithnjë sipas Nathalie Piegay; “*kjo mund të jetë edhe një lojë e ndërlikuar në raste të caktuara kur vendoset referenca ndërmjet trillimit dhe realitetit, apo rrëfyesit dhe autorit*”. (Piegay, 2011, f. 70). Sepse sipas saj, referenca nuk mjaftohet me përshkrimin e një ngjajshmërie, psh. ndërmjet dy personazheve të trilluara nga vet autori.

Fundja, anjë vepër nuk mund të jetë krijim i pastër i autorit të saj, sepse; ndërhyrja e tij thjeshtohet në përzierjen, përkatësisht, kombinimin e copëzave që ai ka mbledhur. Apo siç

shprehet vet autorja Piegay në “Poetika e tekstualitetit,” *praktika të tilla shprehin një thyerje të thellë në lidhje me traditën. Jo vetëm që intertekstualiteti, citimi, referenca, pastishi, parodia...në fakt të citosh njësoj copëza veprash klasike dhe copëza shtypi, kjo është t’i rrafshosh shkrimet, të zhdukesh parimet hierarkike që janë menduar t’i strukturojnë ato*”. (Piegay, 2011, f. 206)

2.5.5. Vjedhja si intertekstualitet

Ndërsa, njëra ndër format e fshehura të intertekstualitetit gjatë një shkrimi të një teksti është vjedhja. “*Vjedhja është ndaj intertekstualitetit të fshehur ajo çka citimi është ndaj intertekstualitetit të hapur*”, thotë Nathalie Piegay Gros në studimin, Poetika e Intertekstualitetit (Piegay, 2011, f. 71). Thënë më qartë; vjedhja më së miri përkufizohet si një citim askund i vendosur. Ndërsa është e njohur se si metafora për dukurinë apo fenomenin e vjedhjes janë plaçkitja ose zhvatja. Pra, vjedhja e një teksti, apo për më keq, e një vepre, është një formë klasike e mashtrimit e cila jo vetëm që e vendos në pozitë të vështirë “ndershmërinë” e vjedhësit, por e ç’rregullon lëvizjen e teksteve. Vjedhja nuk është vetëm një dukuri e përcaktuar- futja e fshehtë e një teksti në një tjetër, por ajo mund të shpreh një thyerje thelbësore në konceptimin e sajimit të veprës letrare. Si e tillë, ajo cenon jo vetëm identitetin e veprës por edhe marrëdhënien që çdo tekst mban me tërësinë e teksteve tjera.

2.5.6. Aluzioni si intertekstualitet

Në të shumtën e rasteve aluzioni është krahasur me citimin, mirëpo ai nuk është as i mirëfilltë e as i hapur (megjithatë më shumë anon kah citimi i fshehur). Psh. Nathalie Piegay Gros në studimin, Poetika e Intertekstualitetit, duke e cituar Charles Nodier në studimin “Çështje të ligjshme letërise”, konstaton se: “*një citimi i mirëfillt nuk është asgjë tjetër, veçse prova e një erudicioni të lehtë dhe të zakonshëm; por një aluzion i bukur është nganjëherë vula e gjenisë*”. (Piegay, 2011, f. 74). Kjo e vërtetë qëndron sepse e nxjerr në pah në një mënyrë tjetër kujtesën dhe zgjuarsinë e lexuesit dhe nuk e lëndon rrjedhën e tekstit. Për Charles Nodier: “*aluzioni gjithmonë është një mënyrë e zgjuar për t’i sjell diskutimit një mendim tejet të njohur, në atë mënyrë që ai ndryshon nga citimi në këtë që ai nuk ka nevojë për të thënë emrin e autorit i cili është i njohur për të gjithë, dhe sidomos ngaqë veshja që ai merr është më pak një autoritet, siç është citimi i mirëfilltë, se sa një thirrje e goditur ndaj kujtesës së lexuesit*”. (Crapelet, 1828).

Kur aluzioni paraqitet si formë e intertekstualitetit si dërgim i tërthortë te letërsia, ai në mënyrë të veçantë kërkon vëmendjen e lexuesit. Aluzioni letrar nënkupton në realitet se lexuesi do ta kuptojë me fjalë të zbuluara atë çka autori dëshiron t'ia thotë, pa i thënë hapur. Leximi i tekstit dhe prurja e kritikës letrare kalojnë fillimisht përmes një shpjegimi të hollësishëm të aluzionit: citimi që e parashtron atë paraqet tekstin të cilin aluzioni e mendon kalimthi në mungesë.

Vetëm më pastaj, ai do të mund të shfaqet përsëri si regjim aluziv, domethënë të fshehur, e që është veçori e tij. Sipas Nathalie Piegay Gros në studimin, Poetika e Intertekstualitetit: *“interteksti e prish përfundimisht tiparin e vetëm (monolitik) të domethënies së tekstit letrar: duke futur aty një element heterogjen (që ka tipare të ndryshme nga burimi e nga përmbajtja), duke iu referuar një kuptimi tashmë të vendosur ai thyen çdo njëzëshmëri.* (Piegay, Poetika e Intertekstualitetit, 2011)

Ai poashtu këput njëtrajtësinë e leximit duke kujtuar kujtesën e një teksti tjetër. *“Së fundi ai ndryshon në thellësi statutin e tekstit: estetikët moderne kanë vënë kështu theksin mbi heterogjenitetin dhe ndërhyrjen, që të dyja përbërëse të tekstit në të cilin ia behin copëza të tjera”.* (Piegay, 2011, f. 104). Prandaj edhe mund të themi se intertekstualiteti si i tillë, i vendosë në funksion mënyrat e domethënies apo kuptimit të tekstit letrar, kushtet e leximit të tij, konceptimin dhe natyrën e tij të thellë përmbajtësore.

Në fakt, intertekstualiteti është i kuptuar si një forcë e pastër në veprim në çdo tekst, çfarëdo qoftë ky i fundit. Sepse teksti letrar sipas Kristevës, e cila në këtë pikë e rimerr teorinë e Bekthinit, sjell jo vetëm jehonën e shkrimeve të mëparshme por edhe të diskutimeve që shkojnë krahas tyre. Për autoren *‘nëse intertekstualiteti është një element përbërës i letërsisë, vlera e tij nuk qëndron në objektin intertekst, për në procesin i cili, sipas saj, themelon intertekstualitetin’.* Përgjithësimi i termit të intertekstualitetit por edhe vet përkufizimet e tij janë të ndryshueshme, ndërsa caku është gjithashtu i pasigurtë. *“Në këtë pikëpamje, intertekstualiteti nuk është mendim sipas një modeli vertikal, mendim i traditës dhe i përcjellur dorë më dorë, por sipas modelit horizontal të shkëmbimit në gjuhën rrethuese”.* (Piegay, 2011, f. 45).

Prandaj ky model horizontal i shkëmbimit intertekstual, është shumë më përmbajtësor dhe më i qartë për lexuesin, njëjtë siç do ta hasim në veprën Kush e solli Doruntinën të Ismail Kadaresë.

KREU III

3.1. Balada si krijim epiko-lirik

Gjatë krejt rrjedhës historike, tradita popullore është frymëzuar nga motivet biblike. Është shumë interesant fakti se duke marrë shkas pothuajse nga i njëjti motiv biblik, siç është motivi i ringjalljes, për shembull, apo ai i fjalës së dhënë, poashtu prej shumë ngjarjeve tronditëse që e kanë përshkruar jetën e tyre, popujt gjithandej kanë krijuar legjenda të ndryshme të cilat me fanatizëm janë ruajtur dhe përcjellur deri në ditët tona, secila në formën e vet qoftë edhe për nga mënyra e shpjegimit të tyre pa e cënuar asnjëherë thelbin e saj. Baladat janë krijime folklorike **epiko-lirike** në vargje dhe kanë natyrë tregimtare. Në tematikën e baladave shqiptare vendin kryesor e zë një dukuri e mbinatyrshme, për shembull, sakrifikimi i njeriut në ndërtimin e **kështjellës, urës, kishës** etj. *“Poeti - popull i ka transmetuar baladat brez pas brezi duke i mishëruar ato me vlerat e tij shpirtërore. Si krijim gojor balada është shumë e moçme, ndërsa, në të shprehet shpirti i popullit me ndjesitë e mendësinë e tij. Duke hulumtuar baladën dhe duke i shpalosur elementet e strukturës së saj, shohim se ajo përmban të gjithë ata përbërës që i duhen një veprë letrare: ka hyrjen, kompozicionin, thurjen, shthurjen dhe si e tillë magjeps me nivelin e ndërtimit të saj”*. (Dushi, 2004, f. 20). *“Në prozë gjejmë jo vetëm momente, kapituj apo fragmente, por vepra të plota që janë bazuar mbi folklorin”*. (Çaushi, 2001). Ritualin i moçëm i të vdekurit që ringjallet pësoi një përshtatje të pashmangshme gjatë kalimit nga paganizmi në krishterim.

Në traditën folklorike shqiptare hasim edhe variante të tjera të baladës, e cila në rrjedhë të shekujve ka pësuar ndryshime të thella. Ato pasqyrojnë në njëfarë mënyre ndryshimet fetare dhe kulturore të vetë shoqërisë shqiptare. Si do që të jetë, sa më shumë që thellohem tek shfletojmë dhe studiojmë mbrendinë a thelbin e legjendave, mësojmë se, sikurse edhe në përrallat e moçme, ato janë të përhapura nga një qytetërim në tjetrin, brenda një rajoni të caktuar siç është Ballkani me kulturat e përafërta të tyre. Megjithatë sipas shumë autorëve dhe studiuesve të kritikës dhe letërsisë, një gjë është më së e sigurtë; kjo legjendë ka si atdhe Ballkanin.

E njëra ndër to është edhe legjenda Kënga e Kostandinit, e cila ndoshta qindra apo mijëra vjet nga thuerja e baladës, e cila më pastaj u bë frymëzim i krijimeve të veprave të reja nga autorë të ndryshëm, e që ne sot kemi rastin jo vetëm t'i lexojmë ato, por edhe t'i studiojmë duke hedhur dritë në kujtesën historike të njerëzimit në përgjithësi e shqiptarëve në veçanti, njëjtë siç bëri shkrimtari ynë i madh, Ismail Kadare, me romanin *Kush e solli Doruntinën*. Prania e elementëve folklorike dhe kanunore në këtë roman, lexuesit ia shton kërshtërinë dhe vendosmërinë për studim më të detajuar. *Balada "Kostandini dhe Doruntina"* si njëra ndër krijimet më të vjetra folklorike shqiptar, parasegjithash është një legjendë përmes së cilës i këndohen lavde besës shqiptare, zotimit apo fjalës së dhënë, të cilën as dheu nuk e qas dot brenda. Shkrimtari i madh, Ismail Kadare e merr këtë legjendë dhe ndërton me te një triller tërheqës, duke filluar nga kalërimi misterioz i vëllait me motrën e tij. Udhëtimi, i Doruntinës, sipër kalit të të vëllait Kostandinit është motivi kryesor jo vetëm i romanit *Kush e solli Doruntinën*, por edhe vet enigma e ardhjes nga Bohemia, për zgjidhjen e së cilës, Kadare e ka ngarkuar kapiten Stresin. Dhe, vetëm në qoftëse për një moment i referohemi mitologjisë, Kostandini dhe Doruntina (vëlla e motër), sikur na paraqiten me ca elemente inçentuoze, por, autori përmes hetuesit plot pushtet e zhvlerëson këtë narracion, duke e orientuar lexuesin që "fajtorin" e kthimit së Doruntinës me të vëllain ta kërkojë diku gjetkë. Edhe Francesko Altimari në parathëniën e romanit *Kush e solli Doruntinën* thotë se: *njerëzit e zakonshëm instiktivisht rreken ta shpjegojnë enigmën me një mister, ndërsa hetuesve u bie barra e vështirë t'i japin asaj një zgjidhje racionale.* (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 14) Për më tepër, vazhdon Altimari me mëdyshjet e vazhdueshme të Stresit për zgjidhjen e enigmës së ardhjes, se: "Botës mund t'i lejohet të dyshojë, por jo neve, thotë me bindje dhe koherencë Stresi, i cili "së vërtetës" së baladës (shprehja "shkon i vdekuri me të gjallën!", me anë të së cilës zogu, ky ndërlihdës

mediatik mes botës reale dhe asaj irrealë, paralajmëron Doruntinën gjatë udhëtimit nëpër natë), i kundërvë, siç ka vënë në dukje Ali Aliu në teoremën e tij aprioristike, “i gjalli ka kalëruar me të gjallën!, teoremë që nuk ia del dot ta vërtetojë, me gjithë hetimin e kujdesshëm dhe këmbëngulës, shoqëruar me një aftësi të madhe psikologjike. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 14)

3.2. Balada e ringjalljes në letërsinë gojore arbëreshe

Folklori shqiptar e sidomos ai arbëresh është i pasur me motive të shumta, duke filluar nga më të thjeshtit deri te ato motive të ndërlikuara qoftë për kah përmbajtja por edhe vetë shpjegimi i tyre. I tillë është motivi i ringjalljes së vëllait të vdekur për të realizuar premtimin e dhënë sa ishte i gjallë . Ky është ndër motivet më të rënda, më enigmantike, sepse këtu shohim përpjekjet narrative për t`u barazuar me hyjnitë duke kaluar kështu kufijtë e natyrshmërisë apo normalitetit.

Mitologjia është pjellë e folklorit dhe konsiderohet si një ndër letërsitë më të vjetra gojore të pakultivuara. Duke qenë e tillë ajo komunikon me letërsinë e shkruar të të gjitha kohrave. Miti paraqet materialin parësor dhe ajo bëhet shkas për thurjen e artit letrar nga krijimet mitike.

Legjenda për motrën me nëntë vëllezër, është e njohur mirë ndër shumë popuj të Ballkanit. Kjo legjendë pasqyron ngjarjen në mënyrë mjaftë komplekse: ngrihet nga varri vëllai i vdekur, vete tek krushqi e largët dhe e sjell te e ëma motrën e vet, e cila ishte martuar larg vendlindjes, për ta jetësuar kështu fjalën e dhënë, besën. Sipas legjendës, varësisht nga vendet ku tregohen, emrat e vëllezërve dhe të motrave ndryshojnë. Kështu, fjala vjen: “*në variantet bullgare vëllai quhet Konstandin, Millan, Stojan, Llazar, etj., motra Peranka, Jana, Grozdana, Evdokija, etj. Te variantet greke vëllai Konstandin, motra Areti, Evdokia; kurse te variantet*

jugosllave : vëllai Kosta, Millovan; motra Evdokija, Elena e të tjera". (Shala, Letërsia popullore, 2002, f. 189)

Folklori është burim i pashterrshëm prej të cilit kanë dalë personazh të shumtë. E, pjellë folklorike janë edhe personazhet baladës së njohur "Motra me nëntë vëllezër" që sot e njohim më gjerësisht falë romanit të Kadaresë "Kush e solli Doruntinën" Pra, baladën Kadare e përdori si brum, nga i cili e përjetësoi këtë vepër të të mrekullueshme. Në plan të parë, subjekti i kësaj balade duket shumë i thjeshtë, por sa më shumë të thellohesh në të aq më tërheqës bëhet, duke ngre njëkohësisht pyetje dhe dilema të mëdha rreth misterit të ringjalljes së Kostandinit pas mallikimit të nënës së tij. Hyrja e rrëfimit ndërkaq, fillont nga një përshkrim i natyrshëm i cili pasqyron gjendjen normale të një familje: "*Ish një mëm shumë e mirë,*

kisht nëntë djem të hijshëm,

e të dhjetën kish një vajzë,

që e quanin Garentinë" (Shala, Letërsia popullore, 2002, f.

189)

Për të vazhduar pastaj bisedat dhe pospajtimet rreth fejesës dhe martesës të bijës së tyre në një vend shumë të largët, nëntë konaqe larg vendlindjes. Kundërshtimet e para lidhur me këtë martesë vijnë nga e ëma dhe tetë djemtë e saj, përveç njërit prej tyre. E poashtu mospajtimin e kishte shprehur hapur edhe vet motra e tyre e cila aspak nuk dëshironte të largohej nga vendlindja e saj. Në traditën folklorike shqiptare, krahas shumë varianteve tjera hasim edhe atë të Halil Garrisë dhe Fatës, në vend të Kostandinit dhe Doruntinës:

"Pa m'nigjoni vllaznit e mi,

sall ni motë tjetër spat,

si u kujtuet n'Krajli mem tret?

N'vent rrogtarit bukën me ma qitë,

e pat kollaj me m'majtë" ... Halil Garrija

Kështu, varësisht nga dominimet fetare nëpër trevat e caktura, në një moment *Kostandini bëhet Halili Garrija dhe Doruntina bëhet Fata në mjedisin mysliman, ndërsa Dhoqina në mjedisin ortodoks*. (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 13)

“Ore vllazën medet! Ju ka thanë

pse kët nom ju me ma bo,

non kopila me jav pas bo,

mu kaq larg s’osht desht me më dhonë,

une juve shka u kam bo,

non konaqe larg me më dhonë” . (Shala, Demush Shala,

Letërsia popullore, 2002, f. 190)

Pra, edhe përkundër të gjithave, motra asnjëherë nuk iu mban mëri vëllezërve të saj. Nuk u kthen fjalën atyre dhe ka besim kur ata i premtojnë diçka. Ky është një element i kulturës shqiptare.

Ajo nuk u mban meri spse është mesuar të nenshtrohet nga autoritetet e patriarkalizmit.

Mirëpo në fakt, tragjedia familjare fillon me vrasjen e nëntë vëllezërve në luftë. Në romani e Kadaresë *Kush e solli Doruntinën* vdekja e tyre përshkruhet si pasojë e një beteje me një ushtri armike të infektuar nga murtaja:

“Erdh një vit shumë i prapë,

e i korri asaj zonje,

nëntë bijtë në një shesh lufte” (Shala, Demush Shala,

Letërsia popullore, 2002, f. 191) . Në mënyrën arbëreshe të rrëfimit të baladës vëllezërit e Garentinës bien në një luftë, gjë që nuk ndodh në vise tjera. Prandaj, kënga bëhet ndër më të bukurat të këtij lloji:

“Me vrapa dolla në avlli,

të marrë një kërcu të zi,

Të më `piket një stehi,

me vrap m u hoth në kusi,

më helmoi djemt e mi,” (Po aty, f.191)

Sipas studiuësit Demush Shala në Letërsi Popullore, në raste të ndryshme si bie fjala: “te *Aliu dhe Fata, Halil Garia, madje në disa sosh, si te “Motra me nëndë vëllezër”, verbohët edhe e ëma e tyre, gjë që e bën atmosferën edhe më të rëndë. Është interesant edhe fenomenit se, në të gjitha motërzimet e ëma e djemve, shpëton, qoftë nga lufta, nga helmimi i gjarprit apo nga mortaja”.* (Shala, Letërsia popullore, 2002, f. 191) Është ky një problem delikat që padyshim ka edhe një arsye qenësore, e cila e zhvillon ngjarjen pasi vetë Zonja Mëmë duhet t’ia kujtojë Konstandinit të vdekur, fjalën e dhënë. Andaj, ajo një ditë kremteje, kur u ndez nga një qiri të bijve të saj, Konstandinit i ndez dy qirinj dhe fillon të vajtojë mbi varrin e tij. Vargjet në vazhdim flasin për këtë. **“Konstandin o biri im,/ ku është besa që më dhe,/ se do më sillje Garantinën,/ Garentinën të motër?/ Besa jote nën dhe.”**”/

Ndryshe nga variantet e baladës te popujt e tjerë të krishterë të Ballkanit dhe nga versionet shqiptare, në versionet arbëreshe nuk gjejmë mallkimin e nënës, që në formën e vargjeve të rapsodisë së famshme rimerret në roman edhe nga vajtueset që qajnë vdekjen e nënës dhe të së bijës, konstaton Francesco Altimari:

(*Kostandin, të ardhhtë gjëma!, ku e ke besën që më dhe, besa jote nën dhe*”). Vajtueset kujtojnë fatin e trishtë të familjes Vranaj së bashku me fjalët e nënës (“Kostandini vdekur, ç’bën tre vjet pa tretur”), sipas së cilës Kostandinin nuk e kishte tretur dheu, ngaqë nuk kishte mbajtur besën. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 13): **“Dhe natyrisht, është pikërisht mallkimi që i jep shkas në roman rikthimit të përkohshëm të Kostandinit të vdekur mes të gjallëve, për të mbajtur besën që i dha së ëmës se do t’i kishte sjellë sa herë që të donte Doruntinën, martuar me këmbënguljen e tij larg në dhe të huaj, me gjithë kundërshtimin e tetë vëllezërve të tjerë”.** (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 13).

Në kuadër të kësaj legjende ekzistojnë shumë motërzime. Kështu, në një të njërit prej tyre, në vend të Zonjës Mëmë, bisedën me Konstandinin e bën zogu i malit, të cilin e dërgon vetë Garantina, e cila kërkon llogari për besën e dhënë, sepse besa ishte një ndër virtytet më të çmuara të shqiptarëve, virtyt ky që, sipas botëkuptimeve popullore, ngre të vdekurit nga varri. (<http://www.kultplus.com> & wp-content/uploads/2017/09/Tema.docx., 2017) Poashtu, në *Krahinën e Labërisë psh*, ky variant gjendet në disa motërzime, të cilat janë të përafërta me

variantin e bregdetit dhe të arbëreshëve të Italisë, pa i përmendur ato të arvanitasëve në Greqi, i cili është ndër më magjepësit e kësaj balade me ato vargjet tronditëse të mallkimit të nënës, ngritjen e Kostandinit nga varri dhe udhëtimi i tij me motrën në të njëtin kal.. (Merkuri, www.fjalaelire.com).

***Keni parë s'keni parë,
shkon një zogëz bishtbardhë
I vdekuri me të gjallë!***

Kështu, në motërzimet tona Konstandini, Halil Garria dhe Sokol Hyseini, janë ato që ngrihen nga varri në kushte të ndryshme për të çuar në vend besën e dhënë.

Duke qenë se motërzimet janë të shumta, edhe takimet e vëllazërve me motrat e tyre bëhen ndrysh e ndryshe.

Disa takojnë që në fillim vetëm motrën në oborr të shtëpisë, në ndonjë motërzim shohim të takojnë fëmijët e motrës duke lozur etj. Motërzimet tregojnë dallime edhe për ndjenjat e para që ka motra ndaj vëllaut në momentin që shihen.

Në ndonjë motërzim motra sapo e sheh vëllanë i hidhet në përqaftim, kurse në ndonjë tjetër ajo ndonëse e përmalluar shfaq njëfarë droje: E, i tillë është motërzimi me motrën e Halil Garrisë:

“Qyqja,vlla, me ty qysh vi?

Se ktu burri s'më ka qillue

asht nalt n'bjeshk, ka dalë me gjue,

kur t'vi burri, ktu mos më gjejë

i thonë shoqet- Nusja t'ka ikë

erzi em ma gja nuk vie.” (Po aty, f. 189)

Bisedat mes motrës dhe vëllait zhvillohen në variante të ndryshme. Disa fillojnë me pyetje që i drejton motra vëllait ngase ka njëfarë drojtje, kurse në raste tjera shohim të shfaqur dashurinë dhe mallin që shpërthen mes tyre sapo takohen. Në disa nga motërzimet personazh me rëndësi janë edhe zogjtë e malit, të cilët ndjekin situatën dhe habiten me të vdekurin, i cili ec me vajzën e gjallë. E përbashkëta për të gjithë, është se, në të gjitha variantet mbyllja përfundon tragjikisht me vdekjen e Doruntinës dhe Zonjës Mëmë. Në disa raste e gjejmë motrën të

shndërruar në qyqe. Motra me nëntë vëllezër është baladë mjaftë e njohur që këndohet ndër shumë popuj. Më të plotë e kemi në Kosovë. Këtu personazhe kryesore është Dylbere Fatimja, e cila nxit biseda te njerëzit për shkak se ishte shumë e bukur.

“Der këtë çikë Zoti qi e ka falë

Kjo kopila mutllak ka bo:

se kaq larg nuk o desht me dhanë” (Po aty, f. 195)

Sidoqoftë e vërteta e pamohueshme është që: “ *legjenda e Knstandinit dhe Doruntinës shfaqet në forma të ndryshme në Ballkan. Një version popullor grek, “Kënga e Vëllait të vdekur” përqëndrohet në shpëtimin e motrës së Kostandinit, Areti (virtyti). Disa versione të tjera gjenden tek serbët dhe arbëreshët, shqiptarët që jetojnë në Italinë e Jugut, të cilët e kanë origjinën në kohën e Skënderbeut. Sipas Robert Elsie, kjo legjendë është e njohur kudo ku banojnë shqiptarë”* (Morgan , Shkrimtari dhe Diktatura, 1957, 1990, f. 186)

3.3. Kulti i besës (fjalës së dhënë)

“Edhe lisit, po ia dhe fjalën e s’e mbajti, i thahen degët”, thotë populli.

Besa, fjala e dhënë apo kulti i fjalës së dhënë, lidhet me mitin biblik si burim i saj, “në fillim ishte fjala”. (<https://sq.wikipedia.org/>, a.d.) Sepse, ta zëmë, para se të ishte shkrimi çdo gjë rreth njeriut ishte vet fjala. Vetëm të paramendojmë botën tonë pa ligje psh., si do të funksiononte jeta e përditshmëria. Pra, edhe logjika më e thjeshtë njeriun e dërgon të mendimi se fjala e dhënë, megjithatë, ishte një “marrëveshje me shkrim” në mes njerëzëve. Dhe, për të vazhduar jeta, fjala është dashur të respektohej me çdo çmim...

Ky kult madhështor, me përkushtim të veçantë, nëpër shekuj u kultivua edhe nga populli shqiptar. Edhe popuj të huaj e kanë thënë vazhdimisht, “*Nuk ka nevojë për marrëveshje të shkruara me shqiptarët*”. Madje madje, edhe armiqtë shekullorë të shqiptarëve e kanë pranuar këtë të vërtetë të madhe. Sipas rregullave të pashkrurara të shoqërisë shqiptare nëse dikush zotohet me fjalën “*ta jap besën*”, për çfarëdo çështje qoftë, atëherë mund t’i besoni

përfundimisht. *Po të shohim me kujdes Kanunin e Lekë Dukagjinit të mbledhur nga At Shtjefën Gjeçovi, e vërejmë se besa është e ndarë në gjini të ndryshme.* (www.facebook.com & /greeksalbanians/posts)

Artikulli 163 i kapitullit të III-të të Kanunit përcakton rëndësinë e besës si: sjellje besimtare me anë të së cilës gjithkush që ka nevojë që të shlyej një borgj, duhet të japi një shenjë besimi, duke thirrur Zotin të dëshmojë të vërtetën. (www.facebook.com & /greeksalbanians/posts)

Prandaj, kulti i besës nuk është i rastësishëm tek shqiptarët; në legjenda e në balada, në këngë e poezi, në vepra artistike nga më të ndryshmet. Ndaj, nuk ka vend për mëdyshje se *kulti i besës* është i pranishëm edhe në letërsinë shqiptare. Atë e hasim fillimisht në gojëdhëna, në letërsinë popullore, në folklor e romane të shumta.

Për shembull tek legjenda e *Rozafës* dhe ajo e *Urës së fshejt*, aty ku dëshmohet se besa duhet të mbahet edhe kur fjala është për vdekjen e njeriut e zemrës, nënën e fëmijës së tij, (vëllau i vogël). *Apo tek Kostandini dhe Doruntina, ku për të mabjtur besën e dhënë së ëmës, Kostandini ringjallet dhe ngrihet nga varri.* (https://dua.com & besa-shqiptare, a.d.) Ky kult madhështor i shqiptarëve, mbase ishte përcaktues për daljen në dritë të romanit romanit, *Kush e sollti Doruntinën*, nga Ismail Kadare.

E veçanta e këtij romani të Kadaresë është transformimi i kultit të lashtë të besës në modernizëm pasi në shoqërinë moderne familja është themeli i shoqërisë. Ndërsa ky transformim bëhet me modernitetin më të spikatur dhe më finok, nga Kadare, thotë Dominique Fernandez. *“Me njërën këmbë në Shqipërië e moçme, gojore dhe legjendare, ende në rrëqethjen homerike dhe me këmbën tjetër me modernitetin më të spikatur dhe më finok, Kadareja gjendet në kapërcyell të të dy botëve dhe nga kjo rrethanë e jashtëzakonshme vepra e tij krijon akorde të fuqishme dhe të goditura.”* (Dominique Fernandez.) (http://flurudha.blogspot.com & Zejneli, 2016)

Pikërisht familja është shkaku se përse nëna hezitonte martesën e vajzës së saj Doruntinës, shumë larg vendlindjes.

Folklori shqiptar është shumë i pasur edhe në raport me mbajtjen e fjalës, përkatësisht besës dhe rolit të saj , pasuri që në të shumtën është shprehur edhe përmes fjalëve të urta popullore e që i hasim edhe sot e kësaj dite.

Ja disa prej tyre: *“Detit i ka hije vala,*

burrit i ka hije fjala”,

“Muri luan, besa s’ luan”,

“Shqiptari, kur jep fjalën,

“vret djalën” etj

. (illyria.al & <https://www.facebook.com>, 2014)

Këto citime nga fjalë të urta nuk janë frazeologji, por thjeshtë janë realitet kohor, i vërtetuar katërcipërisht e me plot dhembshuri në jetën e shqiptarëve autokton:

KREU IV

4.1. Miti dhe rikthimi i tij te Kadareja

4.1.1. Çka është miti?

Mit qujmë një tregim fantastik i thurrur rreth ndonjë dukurie të natyrës ose të jetës shoqërore, i hasur pothuajse tek të gjithë popujt e vjetër, bazuar dhe i shprehur sidomos në gojëdhëna si rezultat i të cilave lindi edhe mitologjia.

Kur ne flasim për mitin menjëherë mendja na shkon tek legjendat e vjetra, përrallat, baladat, tregimet e moçme, për mite të caktuara brenda tyre e që janë hera – herës të pavërteta, pra të shpikura, që bazohen kryesisht në fantazinë e njeriut, apo rrëfimtari që i sjellë ato.

Duke qenë se gojëdhëna është një ndër mënyrat e para të komunikimit, mund të thuhet se nuk ekziston ndonjë letërsi e cila s'është ndikuar nga letërsia e një populli tjetër, kryesisht mbështetjet e para vërehen më lehtë tek popujt fqinj. Siç ne e kemi rastin psh., me popullin grek. Është gati e pamundur që edhe mitogjia shqiptare të mos jetë e bazuar apo ndikuar nga mitologjia greke dhe anasjelltas. Pra, ndikime nga mitologjia greke vërehen kudo në letërsinë tonë bashkëkohore.

Edhe pse, që në shikim të parë na duken të tillë, të pavërteta e të trilluara, mitet edhe sot e gjithë ditën vazhdojnë të kenë rol dhe ndikim të pazëvendësueshëm në letërsi. Prandaj miti mund të quhet edhe bashkëkrijues i letërsisë moderne pa të cilin vështirë se do të mbijetonte letërsia që e shkruajmë dhe zhvillojmë.

Kështu që është krejt e natyrshme që mitet e lashta sot i hasim kudo në traditat popullore, në legjendat dhe këngët popullore, në ritet dhe elementet tjerë të trashëgimisë sonë të begatë. Ato i hasim poashtu, edhe në krijime tjera artistike në vepra të kohës moderne të cilat kurdoherë janë shndërruar në frymëzim për jetësimin e ideve më të reja dhe kreative për njerëzimin.

4.1.2. Studimi i mitit

Studimi i miteve, në të vërtetë është një dukuri mjaft e gjerë dhe e tillë edhe shumë e vështirë. E vështirë sepse kërkon punë, përkushtim dhe poashtu durim të madh. *“Të studiosh mitet të cilat në vete përmbajnë vjetërsinë, historinë, origjinën, natyrën dhe fenomenet e saj, heronjtë, zotërat dhe rituale të ndryshme të trashëguara, do të thotë që në radhë të parë duhet të jesh njohës i mirë i folklorit, gjuhës dhe psikologjisë shoqërore, thotë studiuesja Viola Isufaj në temën e saj të doktoraturës, tek citon Chevrel- in në letërsinë e krahasuar. Zhdukja, ringjallja, madje lindja e miteve janë elemente të rëndësishme të kërkimit të tipit antropologjik”.* (Chevrel, Letërsia e krahasuar, 2002, f. 80).

Asnjëherë, nuk është e mundur që miti të studiohet dhe të analizohet pa u bërë hulumtimet e nevojshme mbi rolin që ai ushtron në kuptimin përmes të cilit vjen dhe bëhet aktual. Pra mitin si përkufizim mund ta shprehim edhe në formën që e paraqet edhe Brunel P *“Miti rrëfen një histori të shenjtë; ai tregon një ngjarje e cila ka ndodhur në kohët primordiale, në kohën e zanafillës përrallore”* (Brunel P. , Le dictionnaire des myths litteraires, 1998, f. 13).

Së këndejmi mund të themi se duke u mbështetur në mite(të vjetra), gjatë gjithë historisë njerëzore, sidomos në art e në letërsi janë krijuar vepra të mëdha artistike, e poashtu ato vazhdojnë të krijohen edhe sot e kësaj dite, në të gjitha zhanret letrare, e pse jo edhe duke nëpër vepra të tjera të artit si: pikturë, skulpturë, këngë e valle, teatër, dramë e deri te prodhimi i filmave modern në ditët tona.

4.2. Miti në letërsinë shqiptare

Sikurse në të gjitha letërsitë e botës, edhe në letërsinë shqiptare, sipas burimeve të qarkulluara nëpër dekada e shekuj deri në ditët tona, miti, krahas identitetit që përmban, por edhe narrativës tregimtare letrare, ka tiparet kryesore të tij të degëzuara në rite e besime popullore siç janë: miti i Ringjalljes, miti i Zanës, miti i Bletës dhe mite si : Bajlozi, E bukura e dheut, E bukura e detit, Zjarri, Shtojzovallet etj. *“Autorët arbëreshë të Italisë (rilindas) si J.De Rada në botimet e tij letrare e folklorike, A. Argondica në artikujt e tij në “Ili i Arbëreshëve” e të tjerë, na japin materiale me vlerë për mitologji e besime të’ Arbëreshëve. De Rada, duke u nisur nga qëllime atdhetare, për të bërë kahasje në mes mitologjisë shqiptare dhe asaj të lashtësisë. Zgjidhjet përgjithësisht janë romantike e të pabazuara”*. (sq.wikipedia.org & Mitologjia shqiptare , a.d.)

Në disa raste bëher përpjekje për të treguar bazën unitare të miteve e besimeve të trevës shqiptare (në Shqipëri) me ato të Arbëreshëve të Italisë. (sq.wikipedia.org & Mitologjia shqiptare , a.d.). Mirëpo nëse flasim për marradhëniet ndërmjet letërsisë shqiptare dhe mitit gjërat ndryshojnë paksa. Psh në studimin e tij Rexhep Qosja thotë se: *“në pjesën më të madhe të letërsisë sonë, mitologjia i nënshtrohet një përjetimi romantik, përderisa krijimi i mitit i detyrohet realizmit socialist”*. Në këtë rast sipas studiueses Isufaj: *“Qosja shpreh dyshimin se sa mund ta kenë gjetur fatin e tyre krijues në gjurmët e mitologjisë poetët dhe shkrimtarët”*. (Isufaj,

Miti te Kadareja, 2013). “*Po, megjithëse, gati të tërë i kanë shtrirë duart në këtë thesar (folklori, miti, letërsia popullore), nuk mund të thuhet se të gjithë kanë mbërritur të gjejnë në të edhe fatin krijues... Letërsia popullore për letërsinë e shkruar, kurse folklori në tërësi për letërsinë dhe për artet e tjera është bërë burim i elementeve - i shenjave, i kodeve, që përsëriten prej një vepre te tjetra, prej një autori te tjetri .” (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013).*

“Në vazhdim të analizës së tij lidhur me mitin dhe mitologjinë shqiptare, Qosja shkruan: *Si aktualiteti dhe historia ashtu edhe mitologjia, legjenda, simbolika, në përgjithësi folklori, i nështrohen një strukture të përjetimit romantik në pjesën më të madhe të letërsisë sonë të sotme, prandaj shpesh, bëhen ose mbështetje e shikimeve të folklorizuara, ose mjet stolisës letrar”.* (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013).

“Në kërkim të rrënjëve të këtij fenomeni, për më tepër Qosja vlerëson se krijimi i mitit të letërsisë popullore dhe, në përgjithësi, të folklorit në letërsinë e sotme shqipe dhe në kulturën shqiptare, e kjo domethënë folklorizmi mbi të gjitha, i detyrohet teorisë së realizmit socialist” (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013, f. 33) . Për të nxjerrë kështu përfundimin se “*Mitologjizimi i letërsisë popullore dhe të folklorit ka sjellë, kështu, folklorizimin e një pjese të dukshme të krijimtarisë sonë artistike”.* “*Si pjesë kësaj analize nga studiuesi Rexhep Qosja janë edhe citimet, disa nga simbolet: nusja, krushqit, gjaku, gjarpri, oda, kanuni, si edhe legjenda e miti mbi Kostandinin dhe Garentinën ose mbi Doruntinën”.* (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013, f. 34). E ndërsa kritiku letrar Sabri Hamiti në *Tema letrare* thotë se: “*kultura shqipe, letërsia, është kulturë e kundërvënies, gjithnjë duke i ruajtur bazat mitologjike elementare perëndimore, por po ashtu dhe vulë e autenticitetit të saj.”.* (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013, f. 34)

Sipas studiueses Viola Isufaj, të cituar në punimin e saj të doktoraturës, Hamiti poashtu vëren mbizotërimin e këtyre temave dhe i klasifikon në këtë mënyrë:

Popullore: *Flijimi, Besa, Hakmarrja, Rilindja,*

Historike: *Ilirët, Skënderbeu, Ali Pasha, Lidhja e Prizrenit*

Letrare: *Ura e Shenjtë, Ago Ymeri, Kostandini e Doruntina*

Aktuale: *Jeta e përditshme, Mërgimi*

Të përhershme: *Gjuha shqipe, Rilindja, Heroi, Himni.*

“Flijimi prek heroin në dy tipet e letërsisë, atë orale dhe të shkruar, për të krijuar atë tip heroi, i cili me fatalitetin e vet sublimon idealen në letërsi dhe shembuj të kësaj janë; Gjergj Elez Alia te letërsia popullore dhe Oso Kuka te Lahuta e Malcis e Fishtës”. (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013).

Kurse legjenda prek diskursin; *“besa lidhet me perceptimin kulturor shqiptar të fjalës së dhënë, e cila, e transponuar në letërsi dominon mbi kodet e tjera, qofshin letrare apo kanunore, për të prekur realizimin e saj, bile edhe në situatat më fantastike siç ndodh te balada Kostandini e Doruntina, ku për besën e dhënë tejkalohet vdekja”.* (Isufaj, Miti te Kadareja, 2013)

Por dukuria në fjalë prek edhe veprat e tjera të shkruara shqipe ku personazhi i caktuar, për të mbajtur premtimin a fjalën e dhënë, pra, besën, i thyen të gjitha kodet e tjera: kujtojmë funksionimin ekstrem të besës te Besa e Sami Frashërit, poashtu te Nita e Josip Relës, dhe djaloshin e ri Milosao të De Radës. (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013).

4.3. Miti i ringjalljes dhe miti religjioz

*Burimet dhe të dhënat e shumta në fushën e mitologjisë, na tregojnë se gjatë gjithë historisë njerëzore të shkruar e të përcjellur në letërsi, deri më sot, vetëm tre njerëz janë ngritur nga varri: **Jezu Krishti, Lazari dhe Kostandini.*** (<https://sq.wikipedia.org>). Sipas besimit të krishterë vetëm Krishti, nuk ishte i detyruar të vdes. *“Vetëm vdekja e tij nga të gjitha vdekjet njerëzore, ishte përsosmërisht vullnetare”.* (Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2019)

Ai erdhi që të vdiste dhe me anë të vdekjes së tij t'i çlironte ata që mbaheshin robër nga pushteti i vdekjes me besimin në ringjallje”. (Gjoni 11:25 – 26)Sepse sipas këtij shpjegimi ai do të ringjallët për të shpëtuar pastaj njerëzimin...

Njëjtë siç do ta shpëton *“besën e dhënë”*, Kostandini pas aktit të ringjalljes. Për të krishterët, ashtu edhe për mbarë njerëzit, vdekja mbetet një tragjedi. Kur përballen me vdekjen, të njëjtat duhet t'i shndërrojnë në akte jete. Ata duhet ta përballojnë tragjedinë me besimin në ringjallje. *“Unë jam ngjallja dhe jeta; ai që beson në mua edhe sikur të duhej të vdesë, do të jetojë. Dhe ai që jeton e beson në mua nuk do të vdesë kurrë përjetë”.* (Gjoni 11:25 – 26)

Po ta studiojmë mirë e mirë ngjarjen, në këndvështrimin religjioz do të shohim se ajo ka ndikim të drejtpërdrejtë nga feja e krishterë.

Poashtu, mund të themi se dialogëzon me biblën apo ngjarjet nga bibla. Pra, dialogëzimi është i dyanshëm sepse aty gjejmë shumësinë e dialogëzimit pasi ajo bëhet edhe me librin e shenjtë, Biblën, edhe me baladën shqiptare përkrah saj edhe me baladat balkkanike që komunikojnë njëra me tjetrën.

Dita e Pashkëve është dita kur Jezu Krishti është ringjallur dhe pikërisht *Ditë Pashkësh* ishte dita edhe kur nëna e Kostandinit shkon te varri i tij dhe e mallkon atë për mospërmbushje të premtimit apo për shkelje të besës siç thotë Kadareja në romanin Kushe solli Doruntinën.

Por në aspektin fetar kjo përmbajtje bëhet edhe më natyrshme, sepse Dita e Pashkëve përkon edhe me stinën e bukur të pranverës, stinë gjatë së cilës; çdo bimë dhe çdo gjë tjetër në natyrë ringjallet, pra natyra ringjallet, shpirti ringjallet dhe çdo gjë tjetër rilindë, e pse jo në stinën më të bukur të vitit ringjallet edhe njeriu.

Pas shiut gjithmonë shëndrritë(deli) dielli.(popullore).

Në stinën e pranverës, historikisht, janë ringjallur dhe kanë marrë formë edhe idetë për rilindje të reja deri në përmasa të kryengritjeve për çlirim, pothuajse në të gjitha epokat.

Në mars të vitit 1981 në Prishtinë, ndodhi pranvera'81, filloi ringjallja (lëvizja) që ndryshoi rrjedhat e një shekulli, e njohur si pranvera shqiptare. Në mars të vitit 1998, kulmoi poashtu me ringjalljen e madhe që sot e quajmë pranvera kryengritëse, pranvera e lirisë, ringjallje kjo që rilindi legjendën e kohës sonë, Adem Jasharin, i cili u shëndrrua në mit të përvetshëm duke u bërë motiv kryesor dhe frymëzim për bashkëluftëtarë në luftën për liri dhe besimin në fitore.

Po të flasim për periudhën e ngjarjes, pra ringjalljes së Lazarit, do të vërejmë se mund të ketë qenë koha matriarkale (e kundërta e kohës patriarkale kur sundonte burri), kjo pasi personazhet kryesorë të veprës nuk janë Kostandini dhe vëllezërit e tij të vdekur, as babai i tyre i cili fare nuk përmendet në veprë, por Doruntina dhe nëna e saj. Nga ky këndvështrim, kjo ngjarje përkon me periudhën mes shekujve V- VI – të të erës sonë. Por, ngjarje të tjera që kanë lënë gjurmë nëpër dekada e shekuj, nuk kanë reshtur së ndodhuri, asnjëherë.

Element i ngjashëm me pjesën religjioze të mitit është edhe ngjashmëria mes zisë që mbante nëna pas vdekjes së Konstandinit, me zinë që mbante Nëna Maria pas torturimit të Krishtit. Por gjithsesi kjo nuk nënkupton se Konstandini është njësoj me Krishtin, pasi Krishti ka fuqi mbinatyrore, ai është shenjtor i dërguar nga Zoti, ndërsa Konstandini është njeri i thjeshtë me fuqi njerëzore.

Po të flasim për **numra religjiozë**, vërejmë se përmenden numri 9 (nëntë djem) dhe (nëntë male (nëntë male kaptuar) duhej kaluar për të arritur në Bohemi ku ishte martuar Doruntina) dhe numri 3 (kthim pas 3 vitesh martesë). Në Dhjatën e Re të Biblës ekzistojnë 27 libra, që domethënë $3 \times 3 \times 3 = 27$, dhe përkojnë me Treshen e Shenjtë (Biri, ati dhe shpirti i shenjtë).

4.4. Rimarrja e mitit (si intertekst) nga Kadareja

Është tashmë e vërtetuar se e gjithë letërisa botërore rrjedh nga miti (burimi) dhe te burimi (miti) kthehet. Ndaj, nuk kishte s'i të ndodhte ndryshe as në veprën e shkrimtarit tonë, Ismail Kadare. Me një përsoshmëri të rrallë artistike e letrare Kadareja, pra, e rimerr mitin, për të ndërtuar letërsinë e tij, në mënyrën e tij, për të dëshmuar kështu një individualitet të rrallë në artin e letërsisë. Si njohës i shkëlqyeshëm i antikës, sidomos veprave të Homerit, Euripidit, Eskilit, Virgjilit etj., Kadare në veprën e tij ndërlihdë pjesë të miteve por që kanë një origjinalitet dhe dallojnë në themel.

Pra në asnjë mënyrë nuk mund të themi që nga kjo marrje të kemi një kopjim të drejtpërdrejtë siç ndodhë shpesh në letërsi, por një vazhdimësi të traditës ku mitologjia shqiptare është e baraspeshuar me letërsi tjera, siç është mitologjinë greke e romake. Rrëfimet tjera në romanet e shkruar pas viteve 90-të, të Ismail Kadaresë, krijojnë mundësinë e një interpretimi të mirëfilltë të një poetike letrare, një poetikë të vendlindjes, një poetikë të hapësirës, një poetikë të udhëtimit, një poetikë me intertekst mitik, por assesi një poetikë komuniste...

Lidhur me këtë studiuesi dhe kritiku letrar, Shaban Sinani thotë: *“Shkrimtari që kishte guxuar të kërkonte frymën e Evropës në botën e shkëlqim të arbërore të mesjetës së rilindëse të Evropës, me Kush e solli Doruntinën, Prillin e thyer, Urën me tri harqe, në vend të pasaportës së asaj epoke, statuteve dhe rregulloreve evropiane, zgjodhi të drejtën kanunore, për të përveçuar njeriun shqiptar”* (Sinani, Për letërsinë shqipe të shekullit 20 - të, f. 224)

“Është folur shumë për rrezatimin e grekëve në letërsinë botërore, tek; Eskili, ky humbës i madh, duke nisur nga latinët, Dantja, Shekspiri, Gëteja e gjer te Holderlini, Hauptmani, O. Neili, T. Elioti, Sartri etj. Është hamendësuar me të drejtë, se a do të kishte ferr të Dantes, dhe nëse do të kishte, si do të ishte shestuar ai, pa gjedhet e dikurshme greke. Si do të ishin Hamleti pa Orestin, vallet e magjesticave, njollat e gjakut mbi duart e Ledi Makbethit pa ato të Klitemnestrës, ndërgjegjet e shqetësuar, gjumi i prishur ose plot ëndrra turbulluese, shandanet e natës nëpër mesoret e pallateve-kështjella, ku krimi është duke u përjetuar ose porsa ka ndodhur etj”. (Isufaj , Miti te Kadareja, 2013, f. 31)

Për më tepër, sipas saj; *“rikthimi i mitit në strukturat e veprave letrare, sidomos në modernizëm dëshmoi pikërisht për këtë gjë. Tek Josifi dhe vëllezërit e tij e Thomas Man-it janë ringjallur mitet biblike, Procesi dhe Kështjella e Franc Kafkës janë ngritur mbi mitin e Sizifit, Njëqind vjet vetmi ripërtërin mitin e Edipit dhe novela Gjethurinat e Marques-it mitin mbi Antigonën dhe vëllain e saj”.* (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013, f. 32)

Mirëpo kësaj radhe studimi ynë ka për synim romanin *“Kush e solli Doruntinën”* të Kadaresë, rreth të cilit do të bëjmë përpjekje të flasim e të trajtojmë sidomos në aspektin e mitit dhe interteksualitetit të tij.

Sikurse edhe në vepra tjera të mëdha Ismail Kadare edhe në romanin për të cilin ne po flasim, me një elekuencë të jashtëzakonshme ka bërë që miti të ligjëroj gjatë gjithë narracionit të ndërtuar prej tij. Fakti se mitet janë krijuar nga njeriu – popull, flet më së miri për rëndësinë e madhe që kanë. Pra, miti në bashkëjetesë me artin letrar modern, del se përveç që mundëson krijimin e veprave tërheqëse, është edhe frytdhënës. Për të dëshmuar këtë, mjafton që t’i hedhim një sy letërsisë greke, shtratin ku janë ngritur letërsitë e popujve evropian, sepse *“arti antik”*, sidomos ai grek, ka qenë i lidhur ngushtë me mitologjinë greke, madje edhe i pandarë nga ajo.

Është e pamundur që lexuesi i sotëm t’i kuptojë veprat e Homerit pa pasur njohuri mbi mitologjinë antike greke, meqë pothuajse gjysma e veprimit në *“Iliadën”* dhe *“Odisenë”* e tij zhvillohet në botën e Zotërave.

Prandaj, mund të themi se mitologjia greke paraqet materialin, brumin, truallin e artit antik grek, ashtu siç miti shqiptar paraqet brumin e letërsisë shqiptare në përgjithësi, dhe në veprën e Kadaresë në veçanti. Në vështrim të parë Kadareja shkruan kryekëput vetëm për Shqipërinë. Por ato ngjarje, që s’ia vlen të hedhesh sytë në anë të botës, ai i shndërron në letërsi botërore, shkruan kritikja gjermane e njohur për studimet letrare Anjez Hyfner. (Kuçuku,

Kadare në gjuhët e botës, 2015, f. 195)

Gjithashtu në studimet e autorëve të ndryshëm janë të shumta edhe përkufizimet për mitin. Shumë domethënës është edhe konstatimi që i bën mitit, edhe shkrimtari dhe filozofi francez, Pol Valeri. Sipas tij: *"Mit është emri i çdo gjëje që nuk ekziston, por është prezent duke u falënderuar fjalëve"*. Është fakt që mes mitit dhe asaj që quhet botë e artit ekzistojnë shumë gjëra të përbashkëta apo të afërta, fjala vjen, prania e elementëve fantastikë në vepër, imagjinata, shkrirja e tyre, të cilat, si të tilla janë të pandara nga përjetimet emocionale, dëshirat dhe synimet e personazheve që janë bartës të ngjarjeve në një vepër letrare.

4.5.Miti te romani Kush e solli Doruntinën

Zonja Mëmë dhe nëntë djemtë e saj nga Vranajt e Arbërisë, ndryshe nga e kaluara për kah traditat dhe zakonet, kishin vendosur që vajzën, përkatësisht motërn e tyre ta martojnë në Bohemi (diku në brendi të Evropës, sigurisht në një derë të fisme).

Miqësia e re në mes aleatëve të rinj (albanëve dhe bohemëve) për të forcuar pushtetin e tyre, fillimisht ishte kundërshtuar me forcë nga nëna dhe tetë djemtë e saj, për asyen e vetme, largësinë e madhe. Ishte vetëm Kostandini, vëllu më i vogël i Doruntinës i cili këmbëngulë që kjo miqësi të bëhej realitet. Dhe ashtu ndodhi.

Kushti i vetëm që e mundësoi këtë martesë, ishte premtimi i tij ndaj nënës që Doruntinën do t'ia sillte sa herë që ajo e kërkonte. Rënia në luftë e nëntë vëllezërve nga familja e Vranajve në periudhën tre vjeçare, pothuajse do ta bënte të pamundur mbajtjen e besës që Kostandini i dha së ëmës. Mirëpo, sipas traditës dhe zakoneve të atëhershme të Arbërisë besa e dhënë duhet të ngadhënjë me çdo kusht, prandaj edhe do të ndodhë ringjallja e Kostandinit, ngritja nga varri dhe sjellja e motrës, ashtu siç ishte zotuar.

Ky në fakt është miti i kësaj legjende të mbështetur në motivin e baladës popullore ballkanike i cili u krijua në periudhën e fundme bizantine. Aty ku i ka rrënjët edhe mbështetja e shkrimtarit tonë të vyer, Ismail Kadare tek veprat e tij ;

Kush e solli Doruntinën, Ura me tri harqe dhe Muzgu i përendive të stepës, në të cilat pasqyrohen elemente të epikës legjendare, si pikë kryesore e referencës së tij, tek flet me brumin e e një epoke shumë të largët, e ku motivin e gjen në: baladën e vjetër popullore të bazuar në një ngjarje të periudhës së fundme bizantine ku miqësia e re e krijuar si ndërtim i aleancës dhe martesës së largët e Doruntinës e cila sakrifkohet për këtë krushqi të re, e deri te ringjallja e

Kostandinit për ta asjellur atë të këta janë elementet kryesore që e përshkojnë ngjarjen e cila do të shndërrohet në enigmë të pazgjidhur edhe për faktin se ngjarja e cila në fakt paraqet një pjesë të historisë së shqiptarëve, do të ketë fundin tragjik ku edhe do të vdesin Doruntina dhe nëna e saj.

Në këtë vijimësi, Francesco Altimari në fillim të parathënies së romanit *Kush e solli Doruntinën*, shkruan: *“Tek e shkuara mitologjike dhe historike shqiptarëve Kadare gjen një nga burimet kryesore të frymëzimit për veprat e tij. Rikthimi i guximshëm zgafellave të historisë, që në thelln përbën një shmangie, a, më mirë të themi një kryengritje të mirë-filltë estetike ndaj ortodoksisë ideologjike të realizmit socialist, përkon një akt trillimi që, falë një përpunimi krijues të rafinuar, i lejon të zbulojë dhe aktualizojë simbole, mite, rite dhe legjenda të lashta, në funksion të ringjalljes së vlerave më autentike të kombit”*. (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 8).

Sipas Kadaresë, i cili jo rastësisht i kthehet këtij miti edhe në romanin *Kush e solli Doruntinën*, i cili na bëhet sikur i flet edhe kohës sonë, në mënyrë mahnitëse e lëvizë: mitin që jeton ndër shekuj bashkë me vlerën e lashtësisë dhe misterin vdekje – jetë, dhe motivin e flijimit si ushqim shpirtëroregjithnjë në funksion të pasqyrimin dhe përmirësimit të pamjes së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Dhe të gjitha këto autori i thurë përmes një gjuhe të pasur e plotë rrjedhë, tregimtare ku dominojnë personazhet si: Kostandini dhe Doruntina, pastaj motivi i ringjalljes, besa dhe tradita shqiptare etj etj... Pra tek Kadereja asgjë nuk ndodhë rastësisht, aspirata e tij në përmirësimin e imazhit shqiptar në botë, vazhdon edhe sot e kësaj dite, kur është futur në dekadën e nëntë të jetës së tij. *“Nuk është rastësi fakti që të dy romanet (Kush e solli Doruntinën dhe Ura me tri harqe) frymëzohen nga bota legjendare e baladave të lashta shqiptare dhe ballkanike, që kanë në qendër përkatësisht motivin e flijimit njerëzor në themelet e ngrehinave të gurta dhe motivin e besës. Po ashtu, jo rastësisht elementet e përbashkëta tematike, përshkruese dhe ideologjike shfaqen si pasqyrim ndërtekstor i një rrjeti më të gjërë, që, duke e bërë emblematike dhe të veçantë mënyrën kadareane të koceptimit të letërsisë, e përvijon atë si një vijimësi rrathësh narrativë koncentrikë brenda një veprë “të hapur” të madhe e të vetme, brenda një universi në shtrirje të vazhdueshme e të pafundme”*. (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 9).

Sepse qëllimi kryesor i Ismail Kadaresë është thirrja, përkatësisht ftesa dhe joshja e lexuesit për të mësuar më shumë për mitin e Kostandinit shqiptar të ringjallur në romanin, *Kush*

e solli Doruntinën. *“Duke e ftuar lexuesin ta shqyrtojë vetë këtë aspekt të mrekullueshëm të prozës së Kadaresë dhe t’u kushtojë vëmendje të posaçme personazheve, trojve narrative, që dalin gjithmonë paralele dhe fqinje, këtu do të ndalemi në analizën e përmbajtjes antropologjike të mitit të Kostandinit dhe të funksioneve subversive që ky mit kryen në kuadrin e narrativës kadareane”*. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 10)

KREU V

5.1. Intertekstualiteti në romanin Kush e solli Doruntinën dhe miti si intertekst

Në fushën e gjërë të krijimtarisë letrare botërore dhe në ngritjen e pothuajse të gjithë krijuesve të letërsisë, ndikim të madh ka pasur edhe mitologjia. Duke qenë kështu, studiuesë të mëdhenj kanë dhënë përkufizime të çmuara, por gjithnjë sipas vlerësimeve të tyre ato kanë qenë e mbesin të pamjaftueshme për t'i dhënë vulë këtij nocioni, i cili edhe sot e gjithë ditën, krahas frymëzimit që sjell, vazhdon të mbetet i mjaft i ndërlikuar, sidomos në përkufizimin e çështjeve thelbësore që rëndojnë mbi të.

Sipas Dr.Meral Shehabi – Veseli, në studimin e temës “*Miti si intertekst në poezinë e Naim Frashërit*”, thotë se; autorë të ndryshëm kanë dhënë definicione të ndryshme, që nuk është e mjaftueshme për ta përkufizuar në mënyrë të prerë këtë nocion. Veseli, për më tepër këtë vlerësim e bën edhe më të bazuar kur citon studiuesin, Alfred Uçi: “*Shumica e tyre e kanë përkufizuar si “poezi e vjetër”, “figura të trilluara”, “përrallë e rrejtshme”* (Uçi, Mitologjia, folklori, letërsia, 1982). Balada Kostandini dhe Doruntina (Motra dhe nëntë vëllezërit, Motivi i ringjalljes), që nxjerrë në pah traditat shqiptare siç është besa, është shprehur përmes gjuhës metaforike - alegorike. Zonja Mëmë dhe nëntë djemt e saj e martojnë motrën në Bohemi, diku larg në Evropë. Duke e pranuar këtë krushqi, ”bohemët” bëhen aleatë të arbanëve, siç e quanin vetën fiset shqiptare, përballë rreziqeve të kohës. Ndërsa, në fakt *Doruntina* është ambasadore e ditëve tona.

Duke e lexuar me kujdes veprën e Ismail Kadaresë, e sidomos romanin *Kush e solli Doruntinën*, vërejmë se tekstet e tij janë të formuara në atë mënyrë sa që gjatë interpretimit dalin të ndryshuara gati në mënyrë të pabesueshme, nga tekstet tjera të mëparshme, duke e bërë kështu një transformim të përkryer. Në veprën e tij, Kadare nuk nguron që të mbështetet në elemente të letërsisë popullore duke e njoftuar lexuesin për një lidhje intertekstuale, të mundshme. Si aspekt të intertekstualitetit mund të parashihet edhe vet fakti që këto burime legjendash e baladash kishin për bazë jo vetëm Shqipërinë, trojet e Arbërit, mirëpo këto burime i krahasoi edhe me format apo mënyrat tjera të interpretimit, sidomos nga arbëreshet e Italisë dhe popujt tjerë fqinjë. Teksti parësor për të cilën nuk nguron të fut ne poemat e tij, është letërsia greke. I referohet lexuesit paradigma e ndërtekstorisë, ndërsa si gjetiu te çdo autor, këto paradigma e respektojnë në mënyrë të plotë intertekstualitetin dhe të gjitha parimet mbi të cilat ai është ndërtuar.

Sepse: në *esencë intertekst kemi që në fillim, pra tek ideja e shkrimit e pastaj vet titullit i romanit, Kush e solli Doruntinën.*

Intertekstualiteti do të ishte atëherë, ndoshta fare i thjeshtë dhe në mënyrë të rëndomtë, fakti që çdo shkrim gjendet gjithmonë midis veprave që e paraprinë atë, dhe fakti që nuk është asnjëherë e mundur për ta fshirë letërsinë. (Piegay , Poetika e Intertekstualitetit, 2011, f. 35)

“*Kush e solli Doruntinën*” e autorit Ismail Kadare nuk mund të kuptohet jashtë kontekstit të këngës *Konstantini e Garentina*; njashtu siç nuk mund të kuptohet *Komedia Hyjnore* jashtë kontekstit biblik; apo *Emri i trëndafil* jashtë kontekstit të *Poetikës së Aristotelit* dhe krijimit të kulturës krishtere e kështu me radhë. Sa e varfër do të ishte letërsia evropiane, po të mos ishte letërsia me temë mitike e Greqisë së Vjetër. Apo, si do të kuptoheshin më mirë kodet kanunore shqiptare nga Kanuni i Lekë Dukagjinit pa veprën, **Prilli i thyer** ose sa na ka ndihmuar romani *Kush e solli Doruntinën* për të kuptuar më mirë sfondin historik të mundshëm të një prej vlerave më të larta etno-sociale të shqiptarëve, besën. Me një fjalë, këtu kemi të bëjmë me intertekstualitetin si pikë kyçe e studimit të temës sonë në romanin enigmatik të Kadaresë, e që orientim kryesor ka ringjalljen e Kostandinit për të mbajtur besën e dhënë, për t’i sjellur nënës Doruntinën sa herë që ajo do të kishte nevojë.

Prandaj për të arritur qëllimin, pra, për të përçuar mesazhin e nevojshëm për lexuesin shqiptar, Kadare përmes romanit *Kush e solli Doruntinën*, e vendos në te ritualin e vjetër nga motivi i ringjalljes duke e zbërthyer gati në çdo detaj të mundshëm ngjarjen e mbingarkuar nga pesha e madhe e enigmës ku zgjidhja në të shumtën dukej e pashpresë. “*Rituali i moçëm i të vdekurit që ringjallet pësoi një përshtatje të pashmangshme gjatë kalimit nga paganizmi në krishterim. Për këtë kalim është i vetedijshëm edhe Stresi, që jo më kot në mesazhin që do të na jap në fund të romanit, duke folur për për fatin e Shqipërisë, pranon se ai mit “do të shfytyrohet për t’iu për-shtatur maskave të kohës” Nuk është erastit që teksti i “Doruntinës” dëshmon se miti ruan një lidhje simbolike me festën e lashtë të trëndalifave (“Rosaliae”) a të Rrëshajave, pikërisht në episodin ku Stresi dhe ndihmësi i tij, ndërsa shkojnë në pallatin e Vranajve , në atë “shtëpi hijesh”, ku tashmë po japin shpirt Doruntina dhe e ëma, hasin në “ca fletëza trëndalifi të bardhë”, pra të lules që te romakët e lashtë simbolizon kujtimin e të vdekurve”.* (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 11)

Sipas Francesco Altmarit: “*Enigma e “Doruntinës”, që është vendosur haptas në një kontekst narrativ gotik, zhvillohet brenda në Shqipërinë mesjetare, të dhënat historike dhe gjeografike të së cilës paraqesin kufij tejet të labërguar*”. (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 11). Tema trajton forcën e kodit moral, të besës, i cili e mund edhe kodin natyror mes jetës e vdekjes. Kadare e ka marrë këtë mit dhe e ka shndërruar në tematikë të romanit *Kush e solli Doruntinën*, dhe nga ky aspekt vepra është ndërtuar si interpretim personal i një miti mijëra vjeçar, apo më saktë, teskti është interpretim i një teksti tjetër. Ndërsa, origjinaliteti i kësaj vepre, apo i vet autorit të saj Ismail Kadare, qëndron që nga mënyra interpretuese e mitit e deri te gjuha e përsosur që e përdor. Temë kjo e bazuar në legjendat dhe baladat shqiptare dhe jo vetëm e sidomos në këngën e vjetër Kostandini dhe Garentina. Mirëpo ky intertekst është fare i padukshëm në tesktin që e krijon Kadare në romanin e tij *Kush e solli Doruntinën*.

Pra nga *Eposi legjendar shqiptar*, balada ***Kënga e Konstantinit dhe Garentines. Këtu në fakt në titullin e romanit kemi intertekstin e parë, i ndikuar nga vet balada*** . Dhe, jo rastësisht e shënuam *intertekstin e parë* që e hasim te Kadareja në romanin *Kush e solli Doruntinën*, sespe; të përvijosh udhën drejt zanafillës së intertekstualitetit, kjo është të tregosh se kundër çfarë formash leximi kritik është ngritur ai. Poashtu nëse intertekstualiteti mbulom praktika po aq të vjetra sa dhe ndërtuese të letërsisë, ai pretendon të thyhet me mendimin e përcjelljes dhe të traditës letrare. Titullin e Legjendës e gjejmë në dhjetëra variante të tjera, si psh tek arbereshët e Italisë nga i madhi De Rada, ku herojnt e saj janë ***Kostandini dhe Juredina***. Pastaj e hasim edhe si *Kënga e Dhoqinës*: Balada që në vargun e parë Ditën e Pashkës në drekë flet për një rrefim tjetër nga ai që autori Kadare e paraqet në romanin e tij, por që interteksti është paksa i mbyllur. Sikundër e gjejmë fare të lehtë dallimin si te vargjet: *Ditën e Pashkes së madhe/ Dhoqina na hidhej valle*. Balada e cila mbetet ***mit*** që ecën nëpër kohë, në rastin e “*Kush e solli Doruntinën*” te Kadareja, përveç tjerash është arenë në të cilën trajtohet misteri *vdekje-jetë*.

Subjekti i kësaj balade duket shumë i thjeshtë, por sa më shumë hyn në brendi të saj, krijohet përshtypja se aq më shumë ndërlikohet, sepse çdo rilexim zbulon një fshehtësi, nxjerr në pah një pikëpyetje tjetër. ***“Ish një mëm shumë e mirë,***

kisht nëntë djem të hijshëm,

e të dhjetën kish një vajzë, që e quanin Garenitë, (Shala, Demush

Shala, Letërsia popullore, 2002, f. 189)

Ndërsa në anën tjetër, kënga, “ Besa e Kostandinit nisë me vargjet: *Ish një mëmë shumë e mirë/ e na kish nëntë djelmë bujarë/të dhjetën një vashë/*

Kurse te kënga e Halil Garrisë, vjersha fillon me këto vargje: *Zot ç’ka than Halil Garrija/ be mbi Zotin trimi bani/ pse nant vllazen ne qe jemi/ veç nje motër tjetër skemi/.*

Gjatë krijimit të romanit Kadareja është mbështetur kryesisht mbi motivin e baladës popullore ballkanike, përkatësisht nga jugu i Shqipërisë nga vjen edhe vet.

Ngjarja është e periudhës së fundme bizantine, ku, në sfond është një martesë e largët “**nëntë male kaptuar**”, apo një krushqi si forcim aleancash ku vajza e vetme e familjes Vranaj, Doruntina, duhet të flijohet për interesat e Arbërisë. Pakënaqësi të madhe lidhur me këtë martesë shfaq sidomos e ëma dhe djemtë e saj, përveç Kostandinit, e mos të flasim për Doruntinën të cilës nuk i pëlqente aspak por që s’kishte ç’të bënte, pasi për fatin e saj vendosnin të tjerët. Këtë e dëshmojnë vargjet si më poshtë:

*“Pa m’nigjoni vllaznit e mi,
sall ni motër tjetër spat,*

si u kujtuat n’Krajli mem tret?

Të jesh motër e nëntë vëllezërve, apo bijë e një fisi të madh, të jetosh në kohën e kanunit do të thotë të mbyllësh gojën, sepse vetëm në këtë mënyrë ruhet botëkuptimi i vjetër patriarkal. Përkundër të gjitha sjelljeve, motra zakonisht nuk mbante mëri me vëllezërit e saj. Nuk ua kthen fjalën atyre dhe ka besim të madh kur ata i premtjnë diçka . Tragjedia familjare fillon me vrasjen e nëntë vëllezërve në luftë: “*Erdh një vit shumë i prapë,*

e i korri asaj zonje,

nëntë bijtë në një shesh luftë.” (Shala, Demush Shala, Letërsia popullore, 2002, f. 191). *Kush e solli Doruntinën* shfaqet edhe si pasyrim ndërtekstual i një rrjeti më të gjërë , që, duke e bërë emblematike mënzrën kadareane të konceptimit të letërsisë e përvijon atë brenda një universi në shtrirje të vazhdueshme e të pafundme. Duke eftuar lexuesin ta shqyrtojë vetë këtë aspekt të mrekullueshëm të prozës së Kadaresë dhe t[ua kushtojë vëmendje të posaçme personazheve, si për shembull në momentin e dhënies së besës te

“Kush e solli Doruntinën” moment i cili është edhe themeli i kësaj balade, kur nëna e pyet djalin e saj më të vogël, Kostandinin tre vjet pas vdekjes së tij.

“Kostandin, o biri im,

Ç’ është kjo puna jote,

Që do t’ma çojsh vajzën kaq’ larg?

Se n’e daça unë për gëzim,

Për gëzim pastaj s’e kam.

Në e daça unë për helm,

atë s’e kam, atë s’e kam,

“vete unë mëm’e ta sjell” . (Haxhihasani, Këngë popullore legjendare, 1955, f. 23).

Në të vërtetë intertekstualiteti në veprën e Kadaresë në përgjithësi, ndërsa në veçanti te romani Kush e solli Doruntinën, nuk është e vështirë të vërehet, në përjashtim të disa rasteve ku kemi elemente të përziera ndërtekstorie, në të cilat realisht nuk edhe aq lehtë për t’u nxjerrë në sipërfaqe, apo për t’u kapur, e pastaj edhe për t’u zbërthyer në kuptimin intertekstual përmes një analize të saktë. Sikurse në rastin më të mirë te “Tregime të moçëme shqiptare” të Mitrush Kutelit, i cili me rastin e kalimit nga poezia në prozë, baladën e quan “Besa e Kostandinin”, **ndërsa** në pikun e ngjarjes janë pyetjet e Zonjës Mëmë: “*Kostandin biri im, çfarë po thua ti kështu? Aq larg do ma shpiesh Doruntinën time? Se në daça për gëzim, për gëzim nuk do ta kem; se në daça për helm, për helm nuk do ta kem.* Dhe në anën tjetër kur Kostandini i jep besën nënës së tij, akt ky, të cilin Mitrush Kuteli e përshkruan në këtë mënyrë: *Të jap besën, zonja mëmë,*

se kur ta duash ti Doruntinën,

qoftë për gaz qoftë për helm,

vete unë e ta sjell. (Kuteli, Tregime të moçme shqiptare, 2005, f. 42)

Sipas traditës shqiptare, ta zëmë, *besa* lidhej apo jepej, sidomos për çështje shumë të rëndësishme, siç ishin organizimet për kryengritje dhe rezistencë përballë pushtuesve grabitçarë, pastaj për pajtime të mëdha, për falje gjaqesh e ngatërresa, por poashtu edhe për rregullime të tjera po aq të rëndësishme dhe të nevojshme për përditshmërinë dhe ecurinë e jetës së tyre. Besa lidhej kryesisht në logje trimërisht, pastaj në vende të shenjta si: *kisha, xhamia, teqe, tyrbe*, vende të cilat kishin të krijuara kulte të besimit.

Besa, ndërkaq, jepej edhe në momente vendimtare, si ajo e Kostandinit dhënë nënës së tij. Meqenëse Ismail Kadare ka krijuar shumë vepra të mëdha, nuk e ka aspak vështirë të krijojë, pra aktin e krijimit të ri duke e bërë të ligjërojë mitin, sikurse në rastin e këtij romani. *“Qielli ndonëse i ulur poshtë, ngjante i huaj si rrallëherë. Përbuzshëm mbyllte tejpamjet dhe jo vetëm pleqtë, por shumica e gjindjes ankoheshin për duhmën e tij. Megjithatë, bota s’reshte së foluri. Çdo mëngjes diçka i shtohej e padyshim diçka i hiqej historisë së Doruntinës. Vetëm vajtoret vazhdonin të mos ndryshonin asgjë në ligjet e tyre”.* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 163). Ja si e përshkruan këtë moment Kadare përmes vajtoreve të cilat edhe në rastin më të rëndë nuk po ndryshonin asgjë nga mallkimi nënës së vetmuar (e mbetur pa nëntë djemtë e saj), pra, nga mallkimi bërë Kostandinit mu në ditën e të vdekurve.

“Erdhi dita e të vdekurve, të gjithë bënë vizitat e zakonshme në varre dhe ato, kryeneçe si më parë, i qanë Vranajt me po ato fjalë si herët e fundit”.

“Kostandin, të ardhhtë gjëma,

Ku e ke besën që më dhe?

Besa jote nënë dhe.” (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 163)

Nga një mallkim i tillë nuk të mbron dot, as dheu dhe as varri. Vetëm thirrja e nënës i mundëson Kostandinit të bëjë të pamundurën, të thyej ligjet e jetës e të vdekjes, të ngrihet nga varri dhe të vrapojë natën nën hënë nëpër rrugën e pluhurosur për t’i sjellë nënës motrën e martuar larg, ashtu siç i kishte dhënë fjalën dikur. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 27). Kjo tregon se autori më miri se askush tjetër pati dijet dhe njohuritë e bollshme mbi këtë baladaë

të vjetër ballkanike dhe jo vetëm, por në veçanti të asaj shqiptare gjithandej ka shtrihet Arbëria, me të gjitha narracionet, elementet, ngjyrimet, motivet dhe thuerjet e tyre shumë atraktive.

Dhe kjo vlerë e përbashkët e thesarit tonë folklorik të ruajtur që nga periudha e mesjetës, nuk kishte si mos të gjente edhe përkushtimin tonë letrar gjatë kësaj analize. Siç do të thoshte edhe studiuesi ynë i mirënjohur, Shaban Sinani: “*pikërisht pas tyre gjendet zona e kryehershme e tabusë*”. (Sinani , Për prozën e Kadaresë, 2009, f. 102)

Interpretimi mjeshtror i personazheve të Ismail Kadaresë në romanin *Kush e solli Doruntinën* dëshmon se një pjesë e madhe e letërsisë në përgjithësi është interpretim i një kodi tjetër, e në rastin tonë, i një kodi letrar dhe mitik. Kodi letrar-mitik tregon se vëllai i vogël, Konstantini, e mund vdekjen, ngritet dhe del nga varri dhe nisë udhëtimin e largët për dëshmuar dhe bërë realitet mbajtjen e fjalës së dhënë. Të sjellë Doruntinën te e ëma, sepse ajo ishte besa që e kishte dhënë, e *besa është kodi moral* që në çdo kohë e mund çdo kod tjetër që nga kultura antike e mesjetare shqiptare. *Besimi i një ringjalljeje të njeriut*, ishte gati i pamundur për njerëzit, të cilët besonin vetëm në ringjalljen e Krishtit.

Sipas ungjijve, *Jezusi u ringjall ditën e tretë pas kryqëzimit të tij*. (Gjoni 11:41, a.d.) Edhe Kostandini u ringjall pasi kishte rënë në luftë, bashkë me tetë vëllezërit e tij . “*Ungjilli i Mateut rrëfen që një engjëll u shfaq pranë varrit të Jezusit dhe njoftoi ringjalljen e tij, gruas që shkoi te varri i tij për t’i bërë shërbimet e fundit. Sipas Lukës ishin dy engjëj që rrinin te varri i Jezusit dhe sipas Markut ishte një djalosh i veshur me të bardha. Marku pohon se në mëngjesin e ringjalljes, Jezusi iu shfaq më parë Maria Magdalenës*” (Mark 16:9). Sipas Veprave të apostujve, “*Shën Pali e pa Jezusin gjatë përjetimit të tij në rrugën për në Damask. Jezusi e dha fjalën që do të rikthehej për të përmbushur profecitë mesianike. Atëherë ata e hoqën gurin e varrit prej vendit ku ishte shtrirë i vdekuri. Dhe Jezusi ngriti sytë lart e tha: “O Atë, të falënderoj që më ke dëgjuar”* (Gjoni 11:41). ([https://sq.wikipedia.org/wiki/Jezusi, a.d.](https://sq.wikipedia.org/wiki/Jezusi,_a.d.))

Pra, në këtë rast Jezusi kryente mrekulli me ndihmën e Zotit. Fitorja e Krishtit mbi vdekjen është çlirim i njeriut prej mëkatit, ashtu siç mund të jetë çlirim prej një “mëkati” i Kostandinit pasi të ketë përmbushur premtimin e tij ndaj nënës, për t’i sjellur Doruntinën sa here që ajo i kërkon.

“Në fakt, në roman qoftë thirrja e përsëritur drejtuar Kostandinit për të mbajtur besën, qoftë përkujtimi i të vdekurve, ngjasin në vjeshtë, sikurse është në traditën e vendeve katolike dhe protestante të Europës Përendimore”. (Altimari, tetor 2008)

Në veprën e Kadaresë, *Kush e Solli Doruntinën*, “Ringjallja” e mbetur prej kohësh në një sfond mistik, është analizuar dhe përpunuar nga një aspekt shumë i veçantë.

Dhe, jo pa dashje, hetimet për këtë rast të veçantë e me të cilin nuk ju kishte rënë të takohen më herët njerëzit e asaj treve, (Vranaj e Arbërisë) i mori përsipër i pari i vendit, Stresi. Pyetja kryesore e Stresit në përpjekje për të zgjidhur enigmën; Kush e solli Doruntinën?, është më shumë se përcaktuese e vet titullit të romanit, pyetja kjo që besnikërisht na përcjellë deri në fund në përpjekje për të dhënë një përgjigje të pranueshme që lexuesi e pret me aq padurim. Kush është ai që e solli Doruntinën? Kjo është pyetja këmbëngulëse e kryesuesit të hetimeve, kapiten Strestit, përgjigja e së cilës ngelet e varur diku në mes zingjirit që mban sipër dilemën e të pafund, që nga mesjeta e deri në ditët tona. *“Dështimi i teorëmës së tij e detyron Stresin t’i jap një përgjigje të qartë, po jo gjithaq të thjeshtë, pyetjes që i dha shkas gjithë subjektit intrigues të romanit. Kështu, personazhi që mishëron autorin na zbulon kuçin e enigmës me një pohim ‘revolucionar’ kundër pushtetit dhe formave të tij të ndryshme (politika, shkenca, feja etj), sipas të cilit “Doruntinën nuk e solli askush tjetër, veç se vëllai i saj, Kostandini, fjala e dhënë e tij, besa e tij”.* (Altimari, tetor 2008). Pra, duke qenë kështu, mund të themi se **besës** jo vetëm që nuk i gjuhëzohet jeta, por as vdekja nuk e mund dot. Ajo edhe kur askush nuk e beson, e gjallë në shpirtin e Kostandinit çohet nga varri për ta ruajtur të shenjt thelbin e saj. Funksionimi i mekanizmit të besës dhe Rendit të Ri të Arbërit nënkupton përsëritjen e flijimit për mbrojtjen e atdheut, përsëritjen e martesës së vajzave të Arbërit larg, sprova të reja dhe mundësinë e përsëritjes së mitemës së ringjalljespas besës së dhënë.

Edhe romani *Kush e solli Doruntinën* është ndërtuar gjurmëve të shtratit popullor të baladës që flet për ringjalljen pas besës së dhënë. Kjo baladë është kultivuar te shqiptarët nëpër kohë dhe njihet në disa variante. Kjo për faktin se e njëjta është krijuar në të gjitha trevat e banuara me shqiptarë. *“Tregimi për baladën e ringjalljes ka gjithnjë në qendër një person, i cili ngrihet prej varrit për të përmbushur premtimin që ka dhënë dikur”.* (bibliotekaortodokse, 04,2020)

Psh. “Krishti, Ai ngjallet dhe shëmbëllen me Mesinë. Në Dhiatën e Vjetër kemi rastin e profetit Ilia, i cili u ngrit në qiell me një karrocë të artë”. (<https://sq.wikipedia.org>). “Në Dhiatën e Re, Krishti u ngjall dhe pasi u ngjit në qiell, rri më të djathtë të Atit. Fenomenin e ringjalljes e hasim në baladën e Kostandinit dhe Dhoqinës, e cila ka në qendër të saj, dëshirën e njeriut për të riardhur në jetë, pra ringjalljen e tij.

Në përgjithësi, janë të njohura rreth 300 variante të kësaj balade, mbi të cilat janë ngritur vepra të ndryshme artistike, duke filluar prej romanit. Edhe pse në popuj të ndryshëm emrat e heronjve ndryshojnë, ideja është e njejtitë” (<https://sq.wikipedia.org>). “Aretia dhe Kostandini në greqisht, Dhoqina dhe Kostandini në shqip, Pektana dhe Llazari në bullgarisht, Vojka dhe Kostandini në rumanisht” etj. (Hamzai, Arratia e Konstandinit nëpër gjuhët e Ballkanit, 2009, f. 14). Sikurse: “Balada e vëllait të vdekur ka një shtrirje të gjerë në popujt e Ballkanit. Janë rreth dyzetë e tre variante greke, gjashtë shqiptare, katër kuço-vllahe, pesë rumune, njëmbëdhjetë serbe dhe shtatëdhjetë e tetë bullgare”. (Skëndi, Poezia epike gojore e shqiptarëve dhe e sllavëve të jugut, 1954, f. 75)

Kadare vazhdimisht ka prekur me penën e tij ndodhitë më të mëdha të historisë së popullit shqiptar, ka prekur problemet e jetës, të vdekjes, të dashurisë, krimin, heronjve etj. Sipas Kadaresë, martesat e largëta kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe emancipimin shoqëror, prandaj, pasojat që sjellin këto martesë duket sikur autori deri diku i përliq. Përmes elementit të ringjalljes shohim që besën ta ngrejë shumë lartë, e konsideron si akt të shenjtë. Vargjet në vijim e dëshmojnë pikën më kulmore e baladës, ku i vdekuri udhëton bashkë me të gjallin.

“Kemi parë, s’kemi parë

Shkon i vdekuri me të gjallë,

Hipur mbi të njëjtin kalë” (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f.

69)

Rrëfimi mbi udhëtimin e të gjallit me të vdekurin edhe njëherë na vë në dukje prezencën e groteskut. Në roman Kadare përgjigjen e nënës nga brenda shtëpisë e shpreh habi e dyshim të madh, ndërsa nga vajtorja e katërt, e përshkruan:

Kostandini i vdekur,

Ç'bën tre vjet pa tretur. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f.

70)

Gjithashtu, groteske është edhe vdekja e Doruntinës dhe Zonjës Mëmë, të cilat pësuan nga ngarkesa tragjike. Sipas të gjitha tregimeve në fund vdesin edhe nëna edhe e bija.

Kështu që kënga popullore arbëreshe *Kostandini dhe Garentina*, përfundon me vargjet si në vijim:

*Një në prak e një në derë ,
plasën si qelqi me verë .*

Një lidhje me disa elementë të balades “Kush e solli Doruntinën”, pra një përkapje të intertekstit e hasim edhe në poezinë “Dashuri e humbur” të autorit shkodran Rrepshes, i cituar nga Adrian Zalla në punimin “Mbi botën mitike dhe intertekstuale në poezinë e Rrepshes”. (Zalla, Mbi botën mitike dhe intertekstuale në poezinë e Rrepshes, 2018). *Rrepshes i frymëzuar poashtu nga folkloristika e pasur dhe epika legjendare e baladave në Rrethin e Shkodres, në ca vargje të tij me motive të vargjeve popullore, shkruan:*

“Vetëm kali i zi i pikëllimit

Në shtegun e vjetër më priste.

Kali i zi i pikëllimit ç'më rrëzoi

Dhe rashë si në balada.

Vetëm kali i zi i pikëllimit vjen rrotull

Dhe qan për të zotin e vjetër”. (Zalla, Mbi botën mitike dhe intertekstuale në poezinë e Rrepshes, 07,2018)

“Në folklorin shqiptar kjo baladë paraqitet në disa variante:1) Varianti i Zagories, i njohur me emrin Kostandini dhe Dhoqina, 2) Varianti i Malësisë së Veriut, i njohur si “Besa e Halil Garrisë”, 3) Varianti arbëresh, i cili në Kalabri quhet “Kostandini dhe Gerantina”, ndërsa në Sicili “Kostandini dhe Doruntina”. Mitema e ringjalljes haset edhe tek shkrimtarë të njohur botëror si Xhojsi, Mani, mirëpo Ismail Kadare, ashtu sikurse Markezi, i kthehet traditës kombëtare, baladës shqiptare “Kostandini e Doruntina” duke shfrytëzuar “raportet në formë të opozicioneve semantike elementare dhe antinomive (jeta - vdekja dhe vdekja – jeta), për krijimin

e modelit nacional të jetës”. (<https://sq.wikipedia.org/wiki/Miti>, Miti). Ndërkaq, përmes një narracioni të përkryer që mund ta sjell për lexuesin vetëm Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën* është vetëm njëri nga romanet apo veprat ku identiteti dhe historia e shqiptarëve shkëlqejnë pambarimisht. “Përfundimi i fjalimit të kryepeshkopit me fjalët: “përpyekjet e kishës së Romës për ta shfrytëzuar këtë herezi (mitema e ringjalljes K. R.) kundër kishës së shenjtë bizantine dhe masat e kësaj të fundit për t’i çjerrë maskën kësaj gënjeshtre”), (<https://sq.wikipedia.org/wiki/Miti>, Miti),

“Veprimi artistik i Kadaresë në këtë roman shënon lëvizjen nga miti në histori dhe nga historia në mitin e përforcuar rishtazi, përmes rrëfimitarit tërësisht të pafavorizuar apo “festës së rrëfimit” siç do ta quante Tomas Mani, prandaj në romanin “Kush e solli Doruntinën” “shkrimtari dhe lexuesi (...) mund të takohen si Volteri dhe Zoti, por nuk flasin me njëri tjetrin”. (Gashi, Letërsia dhe miti, 2014, f. 22) .

Por, ka edhe diçka tjetër që të brengosë gjatë leximit të romanit, sepse janë disa gjëra që asnjëherë të sqarohen përfundimisht. Fakti që e ka sjellë i vëllai i vdekur, fillon dhe bëhet diçka e pamundur dhe të shihet thjeshtë si një gënjeshtër nga ana e Doruntinës me arsye të mbulimit të një të vërtete që sipas tyre mund të ketë lidhje me moralin (incestin). Kështu, pas “hulumtimeve të shumta, e sidomos pas gjetjes nëpër arkivat e familjes Vranaj, të një letër- këmbimi të “Zonjës plakë” dhe kontit Topia, e ku ajo i shkruante mikut të saj edhe për problemet familjare, te Stresit fillojnë dyshimet për një incest të mundshëm. “Në disa letra, e sidomos në një të prej tyre, mjaft të hershme, Zonja Mëmë bën fjalë për një ndjenjë, jo të natyrshme të djalit të saj, Kostandinit, ndaj së motrës, Doruntinës”. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 118)

Në përpjekje për të arsyetuar, apo shmangur këtë fenomen të panatyrshëm, ja si e përshkruan Kadare angazhimin e Stresit dhe ndihmësit të tij i cili ishte i sigurtë që e kishin zgjidhur enigmën, përmes përgjigjes që Topia ia kthen Zonjës Mëmë: “E vërteta është që konti e ka kuptuar menjëherë përsë bëhet fjalë, dhe në përgjigjen e tij,-ndihmësi vuri një letër përpara Stresit, - i thotë asaj të mos shqetësohet, sepse këto gjëra janë kalimtare të moshës. Madje, ai i tregon dy-tre shembuj të ngjashëm, në familjet që i njihte, duke nënvizuar se kjo ndodhte sidomos në ato shtëpi ku vajzat janë të vetme, siç është rasti i Doruntinës së saj. Do vetëm pak vëmendje e kujdes që kjo ndjenjë, e çnatyruar paksa, të kthehet në kahjen e duhur. Sidoqoftë, do të bisedojmë hollësisht për këtë porsa të takohemi” (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f.

119). Kështu përfundon përgjigjja e kontit Topia drejtuar Zonjës Mëmë, e cila në një mënyrë është edhe konstatimi i përgjithshëm për këtë ndjenjë jo normale që për fatin e keq edhe mund të ndodhë. Po, përveç kësaj, ku mund ta ketë burimin ky dyshim i hetuesve të prirë nga kapiten Stresi? Apo, rrënjët e tij janë të sjelljet dhe veprimet që Kostandini i bënë në raport me motrën e tij, Doruntinën “*Kostandini shfaq smirë ndaj çdo dhëndri të mundshëm. Kjo është bërë shkak që të prishnim disa krushqi.*

Ndërsa për këtë krushqi kaq të largët ku Doruntina ishte martuar, të gjithë kishin qenë kundër, ndërsa si për çudi kësaj radhe Kostandini kishte insistuar që ta martonin”, (Kadare, Kush e solli Doruntinen, 2004, f. 119).

*“Vet tema e incestit **vëlla e motër**, nuk është e huaj për Ciklin në Ballkan; psh. ekziston në ciklin serb, një baladë ku Stefan Dushani kërkon të martohet me motrën e tij. Në këngë të tjera **incesti** mund të ndodhë në mënyrë aksidentale, ngaqë vëllai dhe motra janë ndarë në fëmijëri dhe nuk e njohin njëri tjetrin; por kjo në këtë rast shmanget. Robert Elsie përmend një aksident të tillë në një baladë arbëreshe; duke e ndërlidhur këtë me praktikën e osmanëve në Ballkan”.* (<https://peizazhe.com> & Vehbiu, 09,2011)

Përndryshe, *inçest të mirëfillt* në Eposin shqip nuk ka (përveç se të rasti i Ajkunës, e cila na del edhe si nënë, edhe si grua, si motër dhe herë si mbesë e Mujit; sepse këto nuk u përkasin të njëjtave linjave narrative); por ka situatë narrative të cilat forcën e tyre dramatike ia detyrojnë tabusë së incestit, e cila qëndron e fshehur në ndërtekst.

“Mirë po pshtetet per deg t’ahit

Pikon loti mbi varr te djalit

Kane lane kangen zogjt e malit

A thu gjokun me ta prue

Dil njehere per me lodrue” (<https://peizazhe.com> /, Hija e rëndë e inçestit, /2011/09/). Poashtu, një situatë të tillë e hasim te balada e Gjergj Elez Alisë;

“ja lan varrat me ujt e gurrës nandvjeçe

ja lan varrat me ata lott e syve,

ja ter gjakun me ata flokët e ballit”,

(<https://peizazhe.com/>, Hija e rëndë e incestit, 2011)

Sipas letërkëmbimit të Zonjës Mëmë dhe kontit Topia, poashtu, shfaqet edhe edhe insistimi i Kostandinit për martesën e motrës larg, dhe kjo ndoshta është aryeja kryesore e cila e ka nxitur atë për një krushqi të largët. *“Mirëpo në një letër tjetër, vite më vonë kjo, kur Doruntina ka arritur moshën e fejesës, zonja plakë i shkruan kontit se Kostandini shfaq smirë ndaj çdo dhëndërrri të mundshëm. Kjo është bërë shkak që të prishen disa krushqi, shkruan ajo”.* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 119)

Me krushqinë e re, pra martesën e Doruntinës në Bohemi, Kostandini sikur u bind se do të shpëtonte nga incesti i mundshëm vëlla e motër. *“Më vonë kur Zonja plakë e njofton kontin për fejesën e Doruntinës, i shkruan, midis të tjerash, se ajo dhe shumica e djemve të saj u lëkundën mjaft për këtë krushq, për arye të largësisë tepër të madhe, por këtë herë ishte Kostandini ai që u tregua, për çudi, tepër i zjarrtë që kjo krushqi të behej. Në letërn e urimit konti i shkruan, midis tjerash, zonjës plakëse qëndrimi i Kostandinit ndaj krushqisë së largët nuk është aspak i çuditshë, përkundrazi, sipas atyre që kemi biseduar, shkruan ai, është e kuptueshme që Kostandinin ta acaronte çdo krushqi e afërt, domethënë, çdo burrë i njohur e i përkitshëm, dhe, përkundrazi, ta kënaqte një krushqi sa më të largët, domethënë, një burrë i panjohur, mundësisht i huaj, sa më larg syve të tij”.* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 119). *“Ju të gjithë keni dëgjuar, besoj, se kjo krushqi e largët, e para e një largësie të tillë, nuk do të bëhej, në qoftë se Kostandini, njëri prej vëllezërve të nuses, nuk do t’i jepte besën nënës se do t’ia sillte Doruntinën sa herë që të lipsej, në gaz apo në zi. Dhe ju e dini se sa shpejt erdhi koha e zisë për Vranajt dhe për Arbrin, por Doruntinë nuk e solli dot askush, sepse dhënësi i besës, Kostandini kishte vdekur, Ju keni dëgjuar për mallkimin që Zonja Mëmë i bëri të birit për shkeljen e besës dhe e dini pastaj se tri javë pas këtij mallkimi Doruntina erdhi, më në fund, në shtëpi”.* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 183). Pas martesës së Doruntinës në viset Bohemisë, do të kalojnë javë, muaj dhe vite, ndërsa asnjë lajm dhe asnjë fjalë nuk do të dëgjohej përgjatë tyre.

Ringjallja e Kostandinit për ta sjell te e ëma, pas mortit të madh në familjen Vranaj, bashkë me pyetjen se kush e solli Doruntinën, për Stresin do të bëhej një detyrë e rëndë. E vështirë do të jetë edhe për shokët e tij.

“Ata nuk e kishin pranuar lehtë shoqërimin me kapitenin. Kishin pasur përherë një ftohtësi ndaj tij, qysh në gjallje të Kostandinit, por kohët e fundit, qysh se Stresi kishte nisur të merrej me zbulimin e misterit të ardhjes së Doruntinës , ftohtësia erdhi e u bë e akullt”. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 164)

Kur Stresi i pyeti katër shokët e Kostandinit, se: *nëse ata besojnë në ngritjen e njeriut nga varri, ata thanë se kjo është diçka e dorës së dytë... s’ka lidhje me thelbin e çështjes.*“ (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 171). Ndërsa ata me këmbëngulje nuk po dorëzoheshin para pyetjeve insistuese në vazhdim nga kryesuesi i hetimeve: *në qoftë se ju s’pranoni ringjalljen e njeriut, si mund të ngulni këmbë për udhëtimin e tij me të motrën?* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 171), ata veç sa e përforcuan përgjigjen që pak më parë kishin dhënë: *O, s’ka asnjë lidhje, zoti Stres... Është diçka e dorës së dytë. Kryesorja është që Doruntinën e solli ai. Ndoshta është puna e dy botëve, që ne nuk po merremi vesh, - tha Stresi, ç’është ëndërr në njërën anë, mund të jetë zhgjiëndërr në tjetrën, apo jo? Ndoshta ... ndoshta...”,* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 171).

Ndaj, si rrjedhë e kësaj edhe Stresi duhet të besonte më në fund se Doruntinën e Vranajve nuk e solli askush tjetër përveç vëllait të saj, Kostandinit. *“Ja përse unë e shpall dhe e rishpall se Doruntinën nuk e solli askush tjetër, veçse vëllai i saj, Kostandini, fjala e dhënë e tij, besa e tij. Asnjë shpjegim tjetër s’ka dhe s’mund të ketë ky udhëtim. S’ka rëndësi, u ngrit apo s’u ngrit i vdekuri nga varri, për ta kryer vetë atë që duhej të kryente, s’ka rëndësi cili qe kalorësi dhe ç’kalë shaloi ai atë natë të errët kur u nis, ç’krahë mbanin frerin dhe mbi flokët e kujt binte pluhuri i udhës. Secili nga ne ka pjesën e vet në këtë rrugëtim, sepse besa e Kostandinit, ajo që e solli Doruntinën, ka mbirë këtu, midis nesh”.* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 184). Për të vazhduar: *“se ç’është kjo forcë e epërme, që është në gjendje të thyejë ligjet e vdekjes”.* (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 184). *Një përmbyllje e tillë ku katërcipërisht autori e arsyeton metatekstin dhe intertekstualitetin e natyrshëm që e përshkon gjithë romanin e ndërtuar mbi krijime e legjenda mesjetare dhe baladat e vjetra shqiptare, siç është Kostandini dhe*

Doruntina, përmes unit të tij identitar, sjell para lexuesit një narracion shumë të veçantë, që ne po e quajmë, tregimi modern kadarian.

Ngjarja në roman zhvillohet në muajt e vjeshtës, dhe autori jo rastësisht e bënë këtë përzgjedhje. Marrëdhënia e romancierit dhe personazhit është aq e ngushtë dhe funksion sipas parimit jep e merr. Pa hyrë në analizë të mirëfilltë të këtij raporti, sjellim ndërmend se, për të arritur sukses në studimin e romanit, më saktë, të personazhit të Ismail Kadaresë - autorit bashkëkohës, duhet të rikujtojmë *Umberto Eko-n*, i cili thotë: *“të punojmë sikur të ishte një autor i së kaluarës”*.

Ky autor i së kaluarës, pikërisht, përmes personazhit të tij, na jep dramën e brendshme shpirtërore me emocionalitet të theksuar, me tendencë të shpalosjes së përjetimit personal, përmes mendimit të ngjeshur; imazhi, përshkrimi dhe domethënia, ngrihen në nivel figure, ndërkohë që ne do të hetojmë se si artikuloohen këta elemente dhe se si japin kuptime të ndryshme me funksion simbolik. Me një fjalë, *“teksti letrar si interpretim i një teksti të tjetër barazohet me kritikën letrare apo me metatekstin e Zhenetit: teksti A e interpreton tekstin B. Në rastin tonë këtë barazim e krijon vetëm fjala “interpretim”, përndryshe asnjë barazim real nuk ekziston midis letërsisë si interpretim i kodeve të tjera dhe kritikës letrare si interpretim i një teksti letrar, si metatekst. Letërsia që interpreton intertekstin dëshmon se; teksti letrar nuk është i lidhur vetëm me botën reale dhe me botën subjektive e personale të autorit, prej të cilëve ajo rrjedh, por ajo është derivat edhe i teksteve të tjera të mëhershme, qofshin ato gojëdhëna apo mite (si te letërsia antike greke), apo kode fetare (si te letërsia europiane me tematikë biblike), apo edhe kode letrare (si në rastin e, *Umberto Ekos, Dan Broën etj*”, (Kosumi B., LETËRSIA SI INTERPRETIM I KODEVE TË TJERA, 2014, f. 207), e posaqërisht sikurse në rastin e shkrimtarit tonë, emblemë, Ismail Kadare në romanin e tij modern, *Kush e solli Doruntinën*.*

5.2. Intertekstualiteti dhe legjenda e pasqyruar në formë letare

Shkrimtari Ismail Kadare, në novelen e tij, *Kush e solli Doruntinën*, për substrat ka marrë baladën gojore të ngritjes nga varri për të mbajtur besën e dhënë, e cila njihet edhe si *“balada e ringjalljes”, “balada e vëllait të vdekur”,* apo edhe thjesht *“balada e besës”*.

Autori e pajis këtë figurë me tiparet e ndershmërisë, ndjenjës së detyrës, logjikës së qartë që nuk errësohet nga bestytnitë dhe nuk përjashton ndjenjat e holla, siç është simpatia e tij

për Doruntinen. Kjo figurë jepet në evolucion. (Kodra, 1980) , ja si na shfaqet në roman: “*Edhe këtu mund të ketë pasur lëkundje: t’ia tregoj të shoqit të vërtetën, apo jo? Ka mundësi që më tepër për arsye njerëzore, për të mos e plagosur në sedër, sesa për ndonjë shkak tjetër, i shkruan se po ikën me të vëllanë, Konstandinin. Aq më tepër që kjo ishte dhe e besueshme, për shkak të besës që ky i kishte dhënë, besë që dihej tashmë nga të gjithë, duke përfshirë edhe të shoqi*”. (Kadare, Kush e solli Doruntinen, 2004, f. 109). Pra këtu vërehet logjika e qartë e Stresit, i cili çdo gjë e mendon me imtësi madje edhe atë, që Doruntina mund t’i këtë shkruar burrit të saj para se ajo të nisej me të dashurin e saj dhe sipas tij ajo e gënjeu, që kishte ardhur vëllai për ta marrë dhe që po largohej me të.

Në fillim autori pasqyron iluzionin e personazhit të vet për mundësinë për të qenë një zbulues i paanshëm i së vërtetës në rrethanat e një shoqërie të ndarë në klasa dhe ku për më tepër mbizotëron ndeshja e këtij iluzioni me realitetin shoqëror. Dhe në fund të novelës tingëllon në mënyrë të fuqishme, përmes fjalëve të Stresit, ideja e qëndresës, ideja e pohimit të vetive të larta morale të popullit shqiptar (Kodra, 1980). “*Ishte ende e rrallë. Sapo kishte mugulluar, ndaj ishte trillane, si një lule e egër, që kishte nevojë për selitje. Dhe për të lehtësuar shpjegimin, ata i kujtuan Stresit një ngjarje, që kishte ndodhur vite më parë, kur Kostandini kishte qenë gjallë, në një katund jo shumë larg prej andej, ku një njeri kishte vrarë mikun e ftuar në shtëpi. Stresi e dinte. Atje qe përdorur fjala “e preu në besë”*”.

Gjithë katundi, të vegjël e të mëdhenj, kishin pësuar një tronditje të rëndë. Dhe vendosën bashkërisht që kurrë të mos ndodhte një kob i tillë. Madje, shkuan më larg: vendosën që kushdo që kalonte në katundin e tyre, i njohur a i panjohur, ishte “në besë”, pra ishte i shpallur e i mbrojtur si mik. I hapej dera në çdo orë të ditës e të natës, i jepej të hante e të pinte dhe ishte i paprekshëm”. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 2014, f. 167). Ndryshe sipas Shaban Sinanit; “*Evonimi i legjendës së ringjalljes ka qenë mërgimi i parë i Kadaresë. Ky ishte një mërgim i veçantë, me një përmasë, vetëm në kohë, privilegj që e fitojnë, bashkë me mbikohësinë, vetëm talentet e fuqishme*”. (Sinani , Për prozën e Kadaresë, 2009, f. 61) Kështu fliste Kostandini në ato pasditet e tyre të paharrueshme te Bujtina e Re, ku s’rreshtin së foluri punë Arbërie. Kuvendonin ose, me saktë, arbëronin, siç thoshin disa, herë mendueshëm e herë me afsh. Ja , unë do t’ia jap besën nënës, se do t’ia sjell Doruntinën nga shtëpia e burrit në çdo kohë që të dojë ajo dhe, sido që të ndodh, edhe i shtrirë po të jem nga sëmundja, edhe me gjysmë shpirt,

edhe me një këmbë apo pa sy, madje edhe....unë nuk e shkel besën. “Edhe ndikimet edhe intertekstualiteti tashmë janë shfaqje të përkufizuara qartë në letërsi (Julia Kristeva, Mihael Bahtin, Zherar Zhenet etj). Ky i fundit ka bërë tipologjinë e marrëdhënieve të tekstit me tekstet e tjera duke dalluar pesë marrëdhëniet e mundshme tekst-një tekst tjetër.” (Zhenet , Hyrje në arkitekst (përktheu Sabri Hamiti) në Figura, f. 985) Pra, edhe te Kadareja në rastin tonë kemi dy tekste që janë tërësisht të ndryshme si tekste autoriale, por që trajtojnë të njëjtën temë si një marrëdhënie e një intertekstualiteti. Teksti i Kadaresë është interpretim i tekstit mitik, pamje e ndryshme, pamje personale ndaj tekstit të parë. Teksti i parë dhe teksti i dytë kanë të përbashkët vetëm tematikën dhe asgjë tjetër. Për ta siguruar tezën tonë, tematika është njëri prej faktorëve të letërsisë, por vetëm njëri dhe jo më i rëndësishmi.

Prandaj dy tekstet kanë të përbashkët një faktor, dhe atë jo më të rëndësishmin. Në të gjithë faktorët tjerë mund të ndryshojnë. (Kosumi B. , 2014, f. 207). “Analizën e mbështesim pjesërisht edhe në teorinë e intertekstualitetit (Bahtin, Kristeva dhe Zhenet). Një afri e mundshme e kësaj letërsie mund të bëhet me kategorinë e hipertekstualitetit të tipologjisë së Zherar Zhenetit. Sipas Zhenet hipertekstualiteti përkufizohet si marrëdhënie midis tekstit A (hypoteksti) dhe tekstit B (hyperteksti) atëherë kur teksti A është i bazuar në tekstin B”. (Kosumi B. , Letërsia si interpretim i kodeve tjera, 2014, f. 208). Apo siç e thonë edhe studiuesit polakë, Anna Burzyńska dhe Michał Paęel Markoëski: “Çdo tekst është i krijuar sikurse mozaiku i civateve, secili tekst ndërfitë dhe transformon një tekst tjetër.”, (Markowski, 2006, f. 177) apo si e përmbledhë më plotësisht Rolan Barti:

“Çdo tekst është një intertekst; të tjera tekste janë të pranishme në të, në nivele të ndryshme, në forma pak a shumë të njohshme: tekstet e kulturës së mëparshme dhe tekstet e kulturës përreth; çdo tekst është një thurje e re citimesh të kaluara...”. (Piegay , Poetika e Intertekstualitetit, 2011, f. 21) “Kush e solli Doruntinën, është në fakt, parashtrim i një enigme dhe “ftesë” për të menduar sipas një mënyre të re, është shenja që sugjeron se kjo vepër e re e artit do të shikohet në marrëdhënie me një baladë paraekzistuese dhe me ndihmën e shoqërimeve që do të bëhen, do ta vërë theksin jo tek dhënia e një përgjigjeje, por tek prirja për zbërthim”. (Isufaj , Miti te Kadareja, 2013, f. 44). Poashtu, “Titulli është boshti i kombinimit ku kombinohen shenjat paraekzistuese me shenja të reja të përzgjedhura nga larmia e pafund që ofron gjuha. Titulli është një mesazh gjuhësor i krijuar sipas marrëdhënieve asociative dhe sintagmatike, në terma

gjuhësorë të Sosyrit: midis marrëdhënieve të mungesës dhe pranisë në gjuhë. Marrëdhëniet midis njësive të pranishme në sekuencë në shembujt e mësipërm janë forma të hapura të ndërtekstorisë të cilat shfaqen në tekst”. (Isufaj , Miti te Kadareja, 2013, f. 46)

Për fund, vlenë të përmendet se edhe studiuesit e vizitorët e huaj janë mrekulluar me besën shqiptare- fjalën e dhënë. Edith Durhami ka nënvizuar se: **“Shqiptarët i mbahen fjalës së dhënë me ndershmëri krejt të panjollësor, se besa justifikon e bën të mundur të pazakonshmen, se shqiptarët me instinktin e një fisniku krenohen me besnikëri të palëkundur ndaj miqve dhe të njohurve”**. Së këndejmi natyrshëm lind pyetja: *Kush e solli Dhoqinën?* Atë e solli fjala e dhënë, besa shqiptare, e cila ngjalli Kostandinin për të plotësuar premtimin.

KREU VI

6.1. Personazhe në vepër - Kategorizimi i tyre

Doruntina - është personazhi më tragjik i romanit. E çiltër, tërheqëse dhe shumë e bukur. Ajo me qetësi të madhe pajtohet me gjithçka që ndodhë përreth saj, nuk e kundërshton martesën e largët dhe beson shumë në fjalën e të vëllait.

Kostandini – në personazhin e romanit Kush e solli Doruntinën, Kostandini pasqyron atributet e një njeriu besnik në radhë të parë, të ndershëm, shumë të dashur dhe fisnik. Këto vyrtyte pothyajse e përshkojnë veprën fillim e mbarim ndërsa që qendër të vëmendjes është ringjallja e tij (ngritja nga varri për të mbajtur besën e dhënë). Këtyre elemente pozitive që e karakterizojnë personalitetin e tij, gjatë gjithë kohës, shohim se sa shumë i vërsulen “hetuesit” në përpjekje për ta vendosur në dimensionin që flet për “ndjenjat” e tij të incestit vëlla e motër, por që asnjëherë nuk janë vërtetuar. Prandaj, edhe në roman Kostandini është mishërim i shpirtit dhe karakterit shqiptar, për të mbajtur **besën** e për të dëshmuar përjetësisht **kultin e saj** qoftë edhe me çmimin e prishjes së prehjes së përjetshme në amshimin e pasosur dhe ngritjen nga varri.

Zonja Mëmë – Forca e nënave – krymbretëreshave të kësaj bote, në romanin Kush e solli Doruntinën, është shprehur më së miri përmes personazhit të Zonjës Mëmë, një botë krejtësisht më vete si dhuratë e fatkeqësive pa mbarim, e cila krahas dhimbjeve jashtëzakonisht të mëdha, pas humbjes së nëntë djemve në luftë dhe mallit më të madh se malet, qëndron stoike e

nuk dorëzohet dot, sepse ka për të pritur momentin e kthimit të Doruntinës, dhe përjetimin epik të mbajtjes së besës nga i vogli e i bukuri i saj, Kostandini.

Stresi – Pyetja kryesore që ngre Ismail Kadare që në fillim të romanit dhe vet titulli i tij, e cila pason përgjigjet aq shumë të kërkuara por të atakuara nga dyshimet dhe dilemat e mëdha për të vënë në lëvizje të gjitha faktet mbi të cilat do t'i ngritë ato gjatë krejt këtij narracioni, e bëjnë Stresin personazhin më kompleks të veprës. Ndër konstatimet më të mira për figurën e tij i vërejm edhe te Francesco Altimari në romanin, *Kush e solli Doruntinën*:

“I brumosur me vullnetin pozitivist, sa të hekurt, aq edhe të pamundur, për të hetuar racionalisht mbi një ngjarje irracionale, që shenjohet nga një varg mbiemrash semantikisht të përshkallëzuar: “ e tmerrshme”, “ e jashtëzakonshme”, “e pabesueshme”, “e pakapshme””. (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 13)

Ajo çka zë vend të rëndësishëm për lexuesin e romanit që është trajtuar edhe në këtë punim, është përqendrimi në ringjalljen e njeriut për të mbajtur **besën dhënë së ëmës**. Se si jepen këto dy forma dhe çfarë kanë të përbashkët e dallime balada me romanin, po e japim në këtë ndarje të mëposhtme:

6.2. Gjetje krahasimesh në mes të baladës dhe romanit

Balada fillon me këto vargje: *“Gjashtë e gjashtë dymbëdhjetë Doruntina trembëdhjetë”*. (Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, 2005, f. 20),

ndërsa **romani**:

“Stresi ishte ende në shtrat, kur iu duk se dëgjoji një trokitje te porta: tang-tang-tang. - Ka ndodhur diçka, - u ngut të thoshte ndihmësi i tij. Zonja plakë e Vranajve dhe bija e saj, Doruntina që ka mbërritur mbrëmë natën, në rrethana krejtësisht misterioze, janë të dyja në kllapi duke dhënë shpirt në shtrat”. (Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, 2014, f. 19)

Në baladë

Në roman

- Jepen vetëm emrat e personazheve; ***Jepet edhe mbiemri Vranaj;***
- Nëna me dymbëdhjetë djem dhe një vajzë; - ***Nëna me nëntë djem dhe një vajzë;***
- Dasma zgjati 9 ditë, ditën e 10 shkon nuse; - ***Nuk jepet kohëzgjatja e dasmës;***
- Nuk jepet vendi i martesës së Doruntinës; - ***Jepet vendi i martesës (Viset e Bohemisë);***
- Nuk jepet mosha e Doruntinës; - ***Doruntina është 23 vjeçare;***
- Nuk jepet koha e ngjarjes; - ***Në stinën e vjeshtës, 11 tetor;***
- Nuk jepet vendi i ngjarjes; - ***Vendi i ngjarjes është Arbëria;***
- Nëna viziton varret të shtunën; - ***Nëna viziton varret të dielën;***
- Nuk dihet sa zgjat udhëtimi i Doruntinës; - ***Udhëtimi zgjat 13 ditë;***
- Kalorësi u pa nga vajzat në valle; - ***Kalorësi shihet nga fëmijët dhe gratë e fshatit;***
- Koha e ngritjes nga varri- mesnatë; - ***Nuk jepet koha e ngritjes nga varri;***
- Nuk ka hetues të ngjarjes; - ***Hetues i ngjarjes është Stresi (me ndihmësin e tij);***
- Në baladë nuk flitet për incestin; - ***Në roman flitet për mundësinë e incestit;***
- Në baladë nuk jepet koha e kthimit; - ***Në roman Doruntina kthehet pas tre vjetësh;***

Fjalët e nënës mbi varrin e Kostandinit në baladë:

“Kostandin, o biri im,/ ku është besa që më dhe/ se do të ma sillje Doruntinën, tët motër / Besa jote vdiq bashkë me ty / e kalbet në varr të zi”. (<https://www.mekulipress.com/>, 11/2020)

Fjalët e nënës mbi varrin e Kostandinit në **roman**:

“Kostandin, ku e ke fjalën që më dhe se do të ma sjellësh Doruntinën sa herë të kem nevojë për të? Tani që mbeta qyqe mbi dhë dhe pranë s’kam askënd, ty që e trete besën, dheu mos të trettë”. (Kadare, Kush e solli Doruntinën, 1997, f. 53)

Ndërsa të njëjta janë detajet:

Në Baladë pajtohet vetëm Kostandini; - Edhe në **roman** pajtohet vetëm Kostandini;

Udhëtim i një të vdekuri me një të gjallë; - Udhëtim i një të vdekuri me një të gjallë;

Kostandini ishte me pluhur; - Edhe në roman *Kostandini ishte me pluhur*;

Në Baladë vdesin nënë e bijë; - Edhe në **roman** vdesin të dyja

PËRFUNDIMI

I skalitur nga një lirikë magjepse, sidomos në përmyllje të tij, dhe i përshkuar nga hipoteza e dilema të mëdha, romani “Kush e solli Doruntinën”, mbetet gjithësesi i përmbushur, i përkryer qoftë për kah narracioni, përshkrimi, personazhet, veprimi dhe gjithçka tjetër që lidhet me të. Një roman i cili të krijon mundësinë e studimit të tij në shumë fusha si në ato të mitit, intertekstualitetit, mundësinë e trajtimit të inçestit brenda romanit, siç është kërkimi këmbëngulës i hetuesit kryesor, Stresit, për fundin e enigmës dhe zbardhjen e të vërtetës.

Në këtë punim magjistrature, përveç tjerash, jemi përpjekur të nxjerrim në pah të shkuarën mitologjike dhe historike të shqiptarëve te vepra “Kush e solli Doruntinën”, pasi që edhe *sipas vet shkrimtarit Kadare, pikërisht* në mjedisin ballkanik, shqiptar, e sidomos atë arbëresh ajo ruan një nga format më të bukura, më origjinale dhe më të lashta, shprehje edhe e vendit qendror që zë koncepti i besës në identitetin dhe kujtesën kolektive të arbëreshëve të Italisë.

Në të vërtetë qasjet e vazhdueshme të autorëve të ndryshëm gjithandej, ndaj çështjes së ndërtimit të narrativës mbi baladën e vjetër apo legjendës së lashtë, asnjëherë nuk kanë pushuar. Njëjtë siç nuk ka rreshtur kurrë, as shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare, sidomos me veprën që ishte bosht për trajtimin e temës sonë.

Prandaj konsideroj se gjatë këtij punimi, detyrë parësore e jona nuk ka qenë hedhja dritë mbi figurën e shkrimtari Ismail Kadare, por synimi kryesor ishte përpjekja për të thënë diçka më shumë rreth krijimtarisë së tij voluminoze, e në mënyrë të posaqme, rreth dukurisë së ndërtesktorisë në romani *Kush e solli Doruntinën* duke filluar nga ideja dhe titulli i tij. Duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë që mbart kjo temë dhe për të arritur qëllimin, nuk kam hezitur që të kërkoj ndihmë nga literatura dhe referimet e domosdoshme nga studiuesit e letërsisë, e poashtu nga mentorja, Dr. Meral Veseli.

Për aq sa kam arritur të analizoj këtë vepër letrare, mendoj se *Kush e solli Doruntinën* mbetet një roman misterioz që në përmbajtjen e vet ngërthen shumë polemika, një roman që flet për Doruntinën e legjendave hipur mbi kalin e të vëllait të ringjallur për të përmbushur besën. Apo, për Doruntinën e vendosur në mes dyshimeve të medha; e solli fjala e dhënë, apo besa shqiptare, siç këmbëngulin moralistët, apo, atë e solli pengu i inçestit, sipas psiko – kritikëve.

Nëse në krejt këto pohime ka diçka nga e vërteta, a mund të themi se, *Doruntinën* e solli rebelimi i mendjes së ndritur të epokës sonë për t'i dhënë legjendës kuptim sublim, ndërsa lexuesit thjeshtësinë e kërkuar me ngulm duke i dhuruar një realizim të përkryer.

Pra, mbrendinë e materies, përkatësisht, atributin e ringjalljes në roman që përshkohet qoftë nga versioni biblik apo ai i një balade laike të Arbërisë, Kadareja përmes personazhit të Kostandinit, me mjeshtri dhe durim e zbret për lexuesin e tij krejt madhështinë e mitit të besës, si askush deri më sot. Me një mprehtësi të jashtëzakonshme përshkrimi, Kadare, kthimin e Kostandinit nga vdekja e bën shumë më të kapshëm e më njerëzor. Dhe frymës së ringjalljes i jep kuptim të cilin, natyrshëm e prek çdo lexues.

Në anën tjetër, gjeniu, IsmailKadare jo rastësisht i është rrekur *motivit të ringjalljes*. Ai zgjodhi që përmes tij të bashkëbisedoj dhe të përçoj porosinë të lexuesit e tij, për Shqipërinë e atëhershme totalitare dhe të katandisur, si përpjekje e sinqertë për ta ndihmuar atë. Pra, ashtu sikurse edhe vepra të tjera të Kadaresë, në romanin *Kush e solli Doruntinën*, ku shfaqen mbizotërojnë karaktere të ndryshme peronazhesh, si ai i nënës qendrestare dhe i bestarit të përjetshëm, Kostandinit, pra, nga autori na paraqitet një botë e narracion krejt më vete, një përfytyrim largëpamës, përtej, që lëvizë pa pushim në botën e tij universal, kërkon me çdo kusht të ndryshojë gjendjen duke përkujtuar ngjarje e fakte nga historia, duke e tërhequr vazhdimisht vëmendjen e lexuesit me porosi shumë të qarta për te.

Prandaj duke e njohur sadopak opusin krijues të Kadaresë, mendjes që i dhuroi mendimin e pastërt letërsisë shqiptare, të shprehur edhe brenda novelës *Kush e solli Doruntinën*, themi se vepra ofron mundësi studimi nga këndvështrime të shumta, jo vetëm për **motivet shqiptare të mitit, të besës e të ringjalljes**, por edhe aspekte e dimensione tjera letrare në tërësi, e në veçanti ndërtekstorinë që kësaj radhe bëjnë përpjekjet tona modeste për ta njerrur në pah, vetëm një pjesë të saj me besimin e plotë se studiuesë të tjerë do të kenë njohuritë e mjaftueshme dhe këmbënguljen për të thënë më shumë rreth krejt kësaj.

Dhe, për vepra të tilla, të mira e në interes për lexuesit, studimet nuk do të mungojnë asnjëherë. E kjo e vërtetë na gëzon pa masë, sepse nëpër pasqyrimet letrare përjetësisht, gjithmonë do të thuhet e do të shkruhet më shumë, e më shumë.

BIBLIOGRAFIA

- *Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, “Onufri”, Tiranë 2014
- *Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, “Dukagjini”, Pejë 1997
- *Nathalie Piegay – Gros, “*Poetika e Intertekstualitetit*” Parnas 2011, Prishtinë
- * (Chevrel, *Letërsia e krahasuar*, 2002, f. 80).
- *Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë*, “Naimi”, Tiranë 2009
- * (Brahimi R. , *Shënime letrare*, 1965, f. 255)
- *Mitrush Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, “Mitrush Kuteli”, Tiranë 2005
- *Arlind Farizi, *Tipologjia e personazheve në romanet e Kadaresë*, (Disertacion), Tiranë 2015
- *Bajram Kosumi, *Letërsia si interpretim i kodeve tjera, Seminarit XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* Prishtinë, 18-30.08.2014
- *Anna Burzyńska & Michał Paęel Markoëski, *Teorie Literatury XX Wieku* (2006),
- *Viola Isufaj, *Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë*, Shtëpia Botuese Onufri, Tiranë
- *Klara Kodra, në revistën “Nëntori” nr. 2, Tiranë 1980.
- *Zhenet, Zherar, “*Hyrje në arkitekst*” (përktheu Sabri Hamiti), në *Figura*, Rilindja, Prishtinë
- *Chevrel, Y. *Letërsia e krahasuar*, PUF, Tiranë, 2002
- *Demush Shala, *Letërsia popullore*, Rilindja, Prishtinë, 2002
- *Osman Gashi, *Letërsia dhe miti*, “OM”, Prishtinë 2014

- *Tefik Çausi, *Universi i Kadaresë*, 2001
- *Arbnora D, *Elemente të epikës gojore në prozën e IKadares*, Instituti Alb, Prishtinë, 2004
- *Alaian Bosquet, *Himn i shumëkuptimshmërisë* R.1 „**Jeta e re**”, nr 2, viti XLII, Prishtinë, 2011
- *Qemal Haxhihasani, *Kenget popullore legjendare*, “Mihal Duri”, Tiranë 1955
- *Y. Jaka n, *Lidhjet letrare shqiptaro-frënge* 1979
- *Revista letrare, *Jeta e re*, nr 2, viti XLII, Prishtinë, 2011
- *Jing, Ke, Shqiperia.com
- * (Brunel P. , *Le dictionnaire des myths litteraires*, 1998, f. 13)
- * (Isufaj, Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë, 2013)
- * (Hamzai, *Arratia e Konstandinit nëpër gjuhët e Ballkanit*, 2009, f. 14)
- * (Uçi, *Mitologjia, folklori, letërsia*, 1982). *(Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, 2015, f. 195)
- *(Genette, 1982) * (La Pensee, 1980, f. 215).I *www.portalishkollor.al
- *[https:// sq.wikipedia.org/wiki/Miti](https://sq.wikipedia.org/wiki/Miti) *[https:// sq.wikipedia.org/wiki/Miti](https://sq.wikipedia.org/wiki/Miti)

